

# BAROMETRI I BARAZISË GJINORE

Në Partitë Politike në Shqipëri

2023



Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

# BAROMETRI

## 2023

I BARAZISË GJINORE  
Në Partitë Politike në Shqipëri

**Tetor 2023**

**Autorët: Edlira Çepani & Mirela Roshi**

Kontribues: Albina Nuredini & Marieta Luka

# Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtimeve	4
Lista e figurave	5
Lista e tabelave	5
Lista e grafikëve	6
1. Hyrje	7
2. Metodologjia kërkimore	9
3. Perspektiva Gjinore e Organizimit dhe Rregulloreve të Brendshme të Partive	10
3.1 Legjislacioni për Barazinë Gjinore, Statutet dhe Rregullat e Brendshme të Partive Politike	10
3.2 Strukturat e Partive Politike për Arritjen e Barazisë Gjinore dhe Perspektiva Gjinore e Organizimit dhe Rregulloreve të Brendshme të Partive Politike në Shqipëri – Pasqyra e Statuteve të Partive Politike	14
3.2.1 PARTIA SOCIALISTE	15
3.2.2 PARTIA DEMOKRATIKE	18
3.2.3 PARTIA E LIRISË	21
4. Përfaqësimi i Vajzave dhe Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e Ndryshme Politike – Zgjedhjet Parlamentare dhe Vendore 2003 – 2023	23
5. Eksperienca dhe Perceptimi i Grave dhe Vajzave Anëtare të Partive Politike në Shqipëri në Lidhje me Barazinë Gjinore Brenda Partive Politike	32
5.1 Gjetjet: Komponenti Sasior – Anketa me Gratë dhe Vajzat Anëtare të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike, Partisë së Lirisë	32
5.2 Gjetjet: Komponenti Cilësor – Fokus Grup dhe Intervista me Gratë dhe Vajzat Anëtare të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe Partisë së Lirisë	42
6. Konkluzione	49
7. Rekomandime	52
8. Bibliografia	55
9. Aneks	56

## Lista e Shkurtimeve

<b>PSD</b> – Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	<b>PV</b> – I Pavarur
<b>PDR</b> – Partia Demokrate e Re	<b>PBL</b> – Partia Bashkimi Liberal Demokrat
<b>AD</b> – Partia Aleanca Demokratike	<b>PDS</b> – Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë
<b>PASH</b> – Partia Ardhmëria Shqiptare	<b>PK</b> – Partia Konservatore Shqiptare
<b>PAA</b> – Partia Agrare Ambientaliste	<b>LSI</b> – Lëvizja Socialiste për Integrim
<b>PBDNJ</b> – Partia për të Drejtat e Njeriut	<b>MEGA</b> Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
<b>PL</b> – Partia e Lirisë	<b>PKKA</b> – Partia Kombëtare Konservatore Albania
<b>PR</b> – Partia Republikane	<b>PS</b> – Partia Socialiste
<b>PDIU</b> – Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	<b>PPSH</b> – Partia e Punës e Shqipërisë
<b>PD</b> – Partia Demokratike	<b>PKSH</b> – Partia Komuniste e Shqipërisë
<b>PKD</b> – Partia Demokristiane e Shqipërisë	<b>AMIE</b> – Aleanca e Maqedonasve për Integrim European
<b>PDS</b> – Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	<b>AGD</b> – Aleanca e Grave Deputete
<b>PBL</b> – Partia Bashkimi Liberal Demokrat	<b>AKK</b> – Aleanca Kombëtare e Grave Këshilltare Bashkiake
<b>PLL</b> – Partia Lëvizja e Legalitetit	<b>FGSSH</b> – Forumi i Gruas Socialiste të Shqipërisë
<b>PBK</b> – Partia Balli Kombëtar	<b>OS</b> – Organizata Socialiste
<b>PDK</b> – Partia Demokristiane e Shqipërisë	<b>FRESSH</b> – Forumi Rinor i Partisë Socialiste
<b>PBD</b> – Partia Bashkimi Demokrat	<b>FRPD</b> – Forumi Rinor i Partisë Demokratike
<b>PBKD</b> – Partia Balli Kombëtar Demokrat	<b>LDGSH</b> – Lidhja e Grave të Partisë Demokratike të Shqipërisë
<b>PESH</b> – Partia Emigracioni Shqiptar	<b>KGSE</b> – Komisioni për Garancitë Statutore & Etikës
<b>PSHA</b> – Partia Shqiptare Atdheu	<b>OJQ</b> – Organizata Joqeveritare
<b>PRDSH</b> – Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	<b>WFD</b> – Fondacioni Westminster për Demokraci
<b>BD</b> – Bindja Demokratike	<b>OSBE</b> – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
<b>PSKSH</b> – Partia Socialkristiane e Shqipërisë	<b>NDI</b> – Instituti Amerikan për Demokraci
<b>PASSH</b> – Partia Aleanca Socialiste Shqiptare	<b>UN</b> – Kombet e Bashkuara
<b>LZHK</b> – Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	<b>RSI</b> – Instituti Robert Schuman
<b>PÇSH</b> – Partia e Çështjeve Shqiptare	<b>EDM</b> – Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje”
<b>APPD</b> – Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet	
<b>ASHE</b> – Aleanca Shqiptare Europiane	
<b>AP</b> – Aleanca Popullore	

## Lista e Figurave

<b>Figura 1</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2001	<b>23</b>
<b>Figura 2</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2005	<b>24</b>
<b>Figura 3</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2009	<b>24</b>
<b>Figura 4</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2013	<b>25</b>
<b>Figura 5</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2017	<b>25</b>
<b>Figura 6</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2021	<b>26</b>
<b>Figura 7</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2003	<b>27</b>
<b>Figura 8</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2007	<b>28</b>
<b>Figura 9</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2011	<b>28</b>
<b>Figura 10</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2015	<b>29</b>
<b>Figura 11</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2019	<b>29</b>
<b>Figura 12</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2023	<b>30</b>

## Lista e Tabelave

<b>Tabela 1</b> – Rregullore, dokumenta dhe politika për barazinë gjinore brenda partive politike	<b>22</b>
---	-----------

<b>Grafiku 1</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike ndër vite Zgjedhjet Parlamentare 2001 - 2021	<b>26</b>
<b>Grafiku 1A</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave si Kandidate për Kryetare Bashkie në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2003 - 2023	<b>30</b>
<b>Grafiku 2</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2001-2021	<b>31</b>
<b>Grafiku 2A</b> – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2003-2023	<b>31</b>
<b>Grafiku 3</b> – Moshë e pjesëmarrëseve në pyetësor	<b>32</b>
<b>Grafiku 4</b> – Arsimi i pjesëmarrëseve në pyetësor	<b>33</b>
<b>Grafiku 5</b> – Profesionin e pjesëmarrëseve në pyetësor	<b>33</b>
<b>Grafiku 6</b> – A e ushtrojnë profesionin gratë dhe vajzat gjatë përfshirjes në parti politike	<b>34</b>
<b>Grafiku 7</b> – Kanali kryesor i hyrjes së grave dhe vajzave në parti	<b>34</b>
<b>Grafiku 8</b> – Ndikimi që kanë disa tregues në frenimin/pengimin e grave për t'u bërë pjesë e partive politike	<b>36</b>
<b>Grafiku 9</b> – Problematikat që gratë dhe vajzat konsiderojnë më sfiduese në politikë	<b>36</b>
<b>Grafiku 10</b> – Sa ndikim kanë disa vështirësi brenda partisë tek gratë dhe vajzat	<b>37</b>
<b>Grafiku 11</b> – Cilat janë detyrat kryesore të forumit të grave në parti	<b>39</b>
<b>Grafiku 12</b> – Opinioni i vajzave dhe grave se sa efektiv është forumi i grave në mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në partinë e tyre politike	<b>39</b>

# 1. Hyrje

Pjesëmarrja e barabartë në politikë dhe garantimi i aksesit të barabartë në jetën politike janë thelbësore për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë demokratike. Në këtë kuadër, Shqipëria ka bërë përpjekje të shumta legjislative për të promovuar pjesëmarrjen e grave në jetën shoqërore dhe politike. Lëvizja për barazi gjinore në politikë dhe në vendimmarrje e nisur prej tashmë më shumë se 20 vitesh, ka patur një arritje të rëndësishme me aprovimin në Parlament të Ligjit “Për Barazinë Gjinore” në vitin 2008, si një themel i rëndësishëm për të gjitha lëvizjet dhe përpjekjet e mëtejshme për barazinë gjinore në Shqipëri. Më pas janë adresuar përmirësime të vazhdueshme të ligjeve si Kodi Zgjedhor, Ligji për Vetëqeverisjen Vendore, etj., për të patur parashikime ligjore të cilat garantojnë në mënyrë efektive barazinë gjinore në politikë dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet.

Falë përpjekjeve të panumërta të aktivistëve për të drejtat e njeriut, të organizatave lokale e ndërkombëtare, të grave dhe vajzave brenda partive politike, përfaqësimi i grave dhe vajzave në politikë dhe vendimmarrje është rritur në mënyrë eksponenciale. Aktualisht, gratë dhe vajzat përbëjnë 34.30% të Parlamentit Shqiptar dhe 70% të qeverisë shqiptare. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2023, 42.19 % e Këshillave Bashkiakë përbëhen nga gra dhe 8 gra janë zgjedhur kryetare Bashkie nga 61 Bashki të Shqipërisë<sup>1</sup>. Siç vihet re, shifrat e përfaqësimit janë historikisht më të lartat aty ku legjislacioni ka parashikuar një kuotë dhe një mekanizëm sanksionesh të rrepta për zbatimin e tij. Nga ana tjetër, në rastet e përzgjedhjes së kandidatëve për kryetarë bashkie, për të cilat legjislacioni nuk parashikon një kuotë, mundësitë që u jepen grave nga partitë politike për të kandiduar janë shumë më të ulëta. Për shembull, në zgjedhjet vendore të vitit 2023, vetëm 15 candidate nga 143 kandidatë në total ishin gra, nga të cilat 8 u zgjodhën kryetare bashkie.

Në përpjekjet e vazhdueshme të punës për fuqizimin e vajzave dhe grave në politikë, rezultojnë se, ndonëse si rezultat i përmirësimit të legjislacionit dhe advokimit të vazhdueshëm për rritjen e rolit të grave në vendimmarrje, ka një rritje të ndjeshme të përfaqësimit në numra, ka ende shumë barrierë të cilat pengojnë fuqizimin real dhe shanset e barabarta për të qenë pjesë e politikës. Përmirësimi i legjislacionit, rregullimi i listave të kandidatëve me kuota dhe masa të tjera të ndërmarra deri tani, kanë arritur një përmirësim të ndjeshëm përse i përket përfaqësimit, por fuqizimi i mirëfilltë realizohet me heqjen e barrierave të identifikuara si pengesat kryesore nga vetë gratë<sup>2</sup>. Disa prej barrierave të identifikuara nga vetë gratë dhe vajzat pjesë e këtij studimi janë:

demokracia e brendshme e partive politike

aksesi i balancuar në financat politike

aksesi i balancuar në media

meritokracia dhe gara brenda partive

dhuna me bazë gjinore në politikë

<sup>1</sup>[www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)

<sup>2</sup>Edlira Cepani & Raquel H. Pena. Nationa Democratic Institute- Gjinia, Paratë dhe Politika, 2017  
[http://www.platformagjinore.al/publikime/#EDM\\_publikime](http://www.platformagjinore.al/publikime/#EDM_publikime)

Pozicioni “i brishtë” i grave të zgjedhura është pasojë e një procesi që ka treguar shpesh mungesë interesi nga partitë politike dhe institucionet përkatëse për të rritur përpjekjet për të adresuar fuqizimin real të grave në politikë dhe vendimmarrje. Të gjitha këto barrierë krijojnë një klimë që nxit pabarazi gjinore, gjë e cila manifeston një nivel të ulët të përfshirjes së grave në arenën politike<sup>3</sup>, duke rrezikuar kështu që politikat e ndërmarra të mbeten një përpjekje formale për të përmbushur kërkesat ligjore. Kjo situatë rrezikon të krijojë dy realitete paralele, njëri në letra me të drejtat e grave për të qenë të barabartë në pozita vendimmarrëse, të përmbushura, dhe tjetri në realitet me mungesën e shanseve reale për të garuar dhe për të qenë të barabarta brenda partive politike.

Për më tepër, mungesa e figurave femërore dhe mbështetja e pakët e qëndrueshme ndaj grave në politikë nuk prek vetëm të tashmen, por krijon gjithashtu një pamje të deformuar sesi brezi i ardhshëm do ta perceptonte jetën politike. Studiuesit arsyetojnë se në një sferë të perceptuar kulturalisht si të dominuar kryesisht nga burrat, pjesëmarrja e ulët politike e grave shoqërohet me krijimin e stereotipeve. Kjo ndikon që brezi i ardhshëm të ketë një motivim të ulët, veçanërisht tek vajzat e reja, për të marrë pjesë në jetën politike dhe si e tillë krijojnë një hendek qëndrimi gjinor në politikë.<sup>4</sup>

Gjithashtu, nga një sërë studimesh të ndërmarra brenda dhe jashtë vendit, rezultojnë se, fuqizimi i grave brenda partive politike, aksesit i barabartë në burime, rritja e kapaciteteve dhe demokracia e brendshme e partive, janë indikatorët kryesorë për një fuqizim real dhe të qëndrueshëm të grave dhe vajzave në politikë.<sup>5</sup>

Aftësia e grave për të qenë përfaqësuese politike, për të kandiduar për poste politike, si dhe aftësia e tyre për të artikuluar çështje me interes, janë faktorë të rëndësishëm për mënyrën se si ato e shohin dhe e perceptojnë veten, si përfaqësuese dhe si një zë efektiv për komunitetin dhe në veçanti për gratë tjera.<sup>6</sup>

Për të pasur një pjesëmarrje efektive të grave në proceset politike, duhet krijuar një sistem solid mbështetjeje dhe zhvillimi për to. Ky sistem do të duhet të transmetojë një vizion të qartë të barazisë gjinore në procese vendimmarrje, për të inkurajuar angazhimin politik të grave dhe për ti nxitur ato drejt përfshirjes dhe ndjekjes së një karriere politike.

Për këtë arsye ky studim, ka për qëllim të hulumtojë dhe të nxjerrë në pah dinamikën kryesore të barazisë gjinore brenda partive politike, duke filluar nga statutet, rregulloret e brendshme, politikat dhe dokumentet e shkruara brenda partive politike e deri tek hapësirat, perceptimet dhe eksperiencat konkrete të grave në kuadër të angazhimit brenda partive përkatëse. Përmes këtij hulumtimi synohet të evidentohen hapat pozitivë të ndërmarra nga partitë politike për t'i zhvilluar më tej si praktika të mira, gjithashtu të evidentohen edhe problematikat të cilat krijojnë barrierë që pengojnë gratë dhe vajzat të kenë shanse dhe akses të barabartë në gjitha zhvillimet politike. Në përfundim të këtij studimi, do të jepen dhe rekomandimet përkatëse, si hapa të nevojshëm për të larguar barrierat që pengojnë gratë dhe vajzat të kenë shanse dhe akses të barabartë në të gjitha zhvillimet politike, pasi pikërisht këto problematika mund të jenë shkaqe (edhe të fshehura) të diskriminimit të grave brenda partive dhe më tej në karrierën e tyre politike.

<sup>3</sup>Eden B. King., Mikki Hebl., Jennifer M. George., Sharon F. Matusik (2010) Understanding Tokenism: Antecedents and Consequences of a Psychological Climate of Gender Inequity  
[https://www.researchgate.net/publication/247570267\\_Understanding\\_Tokenism\\_Antecedents\\_and\\_Consequences\\_of\\_a\\_Psychological\\_Climate\\_of\\_Gender\\_Inequity](https://www.researchgate.net/publication/247570267_Understanding_Tokenism_Antecedents_and_Consequences_of_a_Psychological_Climate_of_Gender_Inequity)

<sup>4</sup>Sarah Glatté & Catherine E. de Vries. Gender Norms and Gender Gaps in Political Participation in Unified Germany  
[http://catherinedevries.eu/Glatte\\_DeVries\\_Feb2015.pdf](http://catherinedevries.eu/Glatte_DeVries_Feb2015.pdf)

<sup>5</sup>Edlira Cepani & Raquel H. Pena. Westminster Foundation for Democracy - Gjinia, përfaqësimi dhe partitë e Djathta. 2022  
[http://www.platformmagjinore.al/publikime/#EDM\\_publikime](http://www.platformmagjinore.al/publikime/#EDM_publikime)

Rumbidzai Kandawasvika-Nhundu The role of political parties on women's participation and representation  
<https://www.idea.int/sites/default/files/publications/the-role-of-political-parties-on-womens-participation-and-representation-en.pdf>

<sup>6</sup>Asiyati Lorraine Chiweza (2016) Women in Local Government. A Potential Arena for Women's Substantive Representation.  
<https://www.cmi.no/publications/5930-women-in-local-government-potential-malawi>



## 2. Metodologjia Kërkimore

Barometri i Barazisë Gjinore për Partitë Politike u realizua mbi një metodologji të përbërë nga disa elementë, për të përfituar një panoramë sa më të plotë të perspektivës gjinore të pranishme në dokumentat kryesore dhe politikave të partive politike (nëpërmjet rishikimit të statuteve të partive), si edhe në eksperiencat e përfaqësimit të grave në partitë politike në Shqipëri (nëpërmjet sondazheve dhe intervistave). Për këtë hulumtim u përzgjedhën 3 partitë kryesore në Shqipëri, të cilat kanë dhe numrin më të lartë të anëtarëve dhe numrin më të lartë të mandateve në parlamentin shqiptar – Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD) dhe Partia e Lirisë (PL) (ish-Lëvizja Socialiste për Integrim).

Procesi i përpilimit të Barometrit të Barazisë Gjinore u zhvillua nëpërmjet kombinimit të metodologjisë cilësore dhe sasore.

Faza e parë u zhvillua nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit në dispozicion (desk review) të partive politike. Gjatë kësaj faze u rishikuan dokumentat bazë të funksionimit të partive politike (statute, politika, dokumenta mbështetës të funksionimit të strukturave të grave dhe vajzave, manifeste, programe dhe struktura të tjera) si dhe u krye një hulumtim mbi legjislativën në këtë fushë specifike. Indikatorët sasiorë, u fokusuan tek numrat e përfaqësimit të grave në strukturat vendimmarrëse të partive, në pozicione drejtuese, në numrin e grave dhe vajzave kandidatë në 15 vitet e fundit, numrin e politikave apo strukturave mbështetëse për gratë, etj. Indikatorët cilësorë u fokusuan tek politikave, ndjeshmëria gjinore e dokumenteve dhe programeve të partisë, aksesin e grave dhe vajzave në financat politike, etj.

Faza e dytë, pas informacioneve bazë të përftuara nga “desk review”, u fokusua në eksperiencat e grave dhe vajzave brenda partive politike. Gjatë kësaj faze të hulumtimit u zhvilluan, intervista, fokus grup dhe një anketim i gjerë, në lidhje me perceptimet dhe përjetimet e grave dhe vajzave brenda partive politike, si dhe realizimin praktik të politikave, parashikimeve statutove apo programeve të partive politike.

30 intervista individuale u zhvilluan me gra dhe vajza nga partitë politike, për të diskutuar përvoja dhe këndvështrime personale, rekomandime dhe informacione të ndryshme, si dhe elementë të “historive të patreguara”. Personat e intervistuar u përzgjedhën në bazë të pozicioneve të tyre, si drejtuese të strukturave të grave, si drejtuese në nivele të larta të partisë dhe si përfaqësuese në parlament dhe në këshillat bashkiakë.

Një fokus grup me gra dhe vajza nga partitë politike u zhvillua në kuadër të hulumtimit të mëtejshëm dhe diskutimit në grup të çështjeve dhe eksperiencave të grave brenda partive politike, aksesin e tyre në struktura, në procese vendimmarrëse, aksesin në financat e partive politike, në përpilimin e politikave, adresimin e dhunës me bazë gjinore të grave në partitë politike, etj.

Për të përmbushur spektrin e informacionit më një bazë më të gjerë, një anketim online u krye me 204 gra dhe vajza anëtare të partive politike për të kuptuar më tej sfidat, mundësitë dhe barrierat e grave brenda partisë politike, dinamikat e proceseve vendimmarrëse dhe strukturat përfaqësuese, aksesin e tyre në financa, etj. Kampionimi gjatë kësaj faze u përbë nga një grup heterogjen anëtarësh të partive politike, në pozicione, moshë, prejardhje të ndryshme, përvoja politike, përkatësi etnike dhe aftësi ndryshe.

## 3. Perspektiva Gjinore

e Organizimit dhe e Rregulloreve të Brendshme të Partive Politike në Shqipëri

### 3.1 Legjislacioni për Barazinë Gjinore, Statutet dhe Rregullat e Brendshme të Partive Politike

Prej vitesh në vendin tonë është në prioritet fuqizimi i kuadrit ligjor dhe institucional në lidhje me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, duke synuar njëkohësisht harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, bazuar në: Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Protokollin Shtesë të saj, Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje si dhe në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2021-2030.

Kuadri ligjor kombëtar, njohja dhe respektimi i të drejtave ligjore të barabarta, ndërmjet grave dhe burrave, theksohen në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, në nenin 18/2,<sup>7</sup> në të cilën promovohen parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit:

“

*“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht, për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore”.*

”

Në Kushtetutë janë parashikuar dhe të drejtat dhe liritë temelore të njeriut si dhe **liritë dhe të drejtat politike**<sup>8</sup>, në nenin 45/1, të saj, përcaktohet se çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.

Barazia gjinore nënkupton pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave, në të gjithat fushat e jetës, në pozita të barabarta mes tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfutur njëlloj nga arritjet e zhvillimit.

Për të rritur pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në politikë dhe në strukturat vendimarrëse, si dhe të gëzojnë të drejtat ligjore, janë bërë përpjekje në vazhdimësi, jo vetëm në harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, në ligje të veçanta, të dedikuara këtyre çështjeve, por edhe në legjislacionin shqiptar në tërësi. Disa nga ligjet kryesore të cilat lidhen pikërisht me këtë trajtohen në formë të detajuar më poshtë:

<sup>7</sup>Kushtetuta e Shqipërisë, 2017. Kreu I, Neni 18, pika 2, faqe 9. <https://klp.al>

<sup>8</sup>Kushtetuta e Shqipërisë, 2017. Kreu III, Neni 45, pika 2, faqe 9.

**Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.** Nga vetë objekti i ligjit, ai rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen dhe ndihmesën e tyre, në zhvillim në të gjitha fushat e jetës. Në këtë ligj parashikohen masa të veçanta për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar në postet politike dhe vendimmarrëse, si dhe mbrojtja nga diskriminimi në sektorët e arsimit, punësimit, medias,<sup>9</sup> etj. Specifikisht sipas nenit 15 të këtij ligji argumentohet:

### Neni 15



*1. Përfaqësimi i barabartë gjinor, në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:*

*a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;*

*b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë, për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;*

*c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;*

*ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;*

*d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.*

Në zbatim të Ligjit nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, me **VKM 400, datë 30.06.2021**, është miratuar **“Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030”**, dhe **“Plani i Veprimit”** që përbëjnë një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individët pavarësisht moshës e gjinisë, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

<sup>9</sup>Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Pjesa III, Neni 15, faqe 6. <https://www.mod.gov.al>

Në nivel vendor **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**, parashikon një sërë detyrimesh për të garantuar barazinë gjinore, si në përfaqësim ashtu edhe në përfitimin e shërbimeve. Detyrimi për garantimin e barazisë gjinore në strukturat vendimmarrëse fillon që nga emërimet e zëvendës kryetareve/kryetarëve të bashkive dhe emërimet e administratoreve/administratorëve, të njësive administrative e deri tek bordet drejtuese të insitucioneve të ndryshme vendore që duhet të zbatojnë dhe respektojnë barazinë gjinore.


Gjithashtu parashikohet mbledhja e detyrueshme e statistikave gjinore nga të gjitha organet shtetërore, si dhe ngritja e strukturave dhe mekanizmave institucionalë për çuarjen përpara të barazisë gjinore. Plotësimi i kuadrit nënligjor për zbatimin e këtij ligji, ndër të tjera edhe me **VKM Nr. 465 datë 16.07.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”**, i hapi rrugën jo vetëm planifikimit të objektivave të matshme gjinore në programet buxhetore të institucioneve qëndrore, por edhe të gjitha hapave të mëtejshëm në drejtim të buxhetimit të përgjithshëm gjinor (BPGJ) në Shqipëri.

**Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, parashikon për herë të parë detyrimin e subjekteve zgjedhore për të respektuar barazinë gjinore. Ky Kod parashikoi në disa dispozita të tij, zbatimin e kuotave gjinore, si në administratën zgjedhore, komisionet e nivelit të dytë dhe në përbërjen e trupit të zgjedhur legjislativ, Kuvendit.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, vendosi detyrimin që në listën shumë-emërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin, asnjëra prej gjinive, nuk mund të përfaqësohej me më pak se 30%. Kjo do të garantohej nga përfshirja në listat shumë-emërore të kandidateve/kandidatëve, të paraqitur nga partitë politike, për zgjedhjet për Kuvendin, për çdo zonë zgjedhore, e kriterit të kuotës gjinore, sipas të cilit të paktën tridhjetë përqind dhe/ose një në tre emrat e parë, duhet t'i përkasë secilës gjini.

Me amendimet që iu bënë këtij Kodi në vitin 2015 u vendos kuota 50% burra dhe 50% gra në listat e kandidateve/kandidatëve për këshilltaret/këshilltarët në zgjedhjet vendore, me mekanizmin një në dy, pra vendosja në listë do të ishte e alternuar midis dy gjinive, duke garantuar rezultatin efektiv të kuotës 50%.

Me amendimet e vitit 2020, me Ligjin nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” u saktësuan përcaktimet, mbi lirinë zgjedhore dhe barazinë gjinore<sup>10</sup> dhe u përcaktua për zgjedhjet parlamentare mekanizmi i vendosjes në listë 1 në 3, pra një në çdo tre kandidatë duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Me këto ndryshime gjithashtu, u hoq përfundimisht edhe gjoba financiare<sup>11</sup> si sanksion për moszbatimin e kuotës dhe mekanizmave përkatës, si dhe u vendos parashikimi i refuzimit të listës nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në rast të shkeljes së dispozitave përkatëse.



<sup>10</sup>Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Pjesa e I, Kreu I, Neni 4, faqe 4, ndryshuar me Ligjin nr. 101/2020, date 23.07.2020 <https://qzb.gov.al>

<sup>11</sup><https://shqiptarja.com/lajm/kqz-gjobe-ps-pd-e-lsi-nuk-br-kane-plotesuar-kuotat-gjinore>

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë së nënpërfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik. Asnjë dispozitë e këtij ligji, nuk mund të zbatohet ose interpretohet, në kundërshtim ose në shkelje të këtij parimi.

Kodi Zgjedhor, gjithashtu nxit barazinë gjinore për organet e zgjedhura dhe administratën zgjedhore përmes:

**a)** vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njëjësive bazë të qeverisjes vendore;

**b)** vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar, në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së të gjitha niveleve të administratës.

**Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>12</sup>** rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, etj. Më qëllim për të siguruar të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Në lidhje me luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë dhe **Ligji nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”<sup>13</sup>** që synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në të gjitha format e saj, janë përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, ndonëse ka ende nevojë të ndjeshme për përmirësimin e mekanizmave të referimit dhe mekanizmave të parandalimit në këtë sektor.

Instrumente të tjerë, në kuadrin e procesit të nxitjes për arritjen e barazisë gjinore, që janë ngritur në kuadër të bashkëpunimit ndërpartiak në organet e zgjedhura të qeverisjes qendrore dhe vendore, janë edhe:

### **Aleanca e Grave Deputete**

**2013**

Aleanca e Grave Deputete (AGD), e cila fillesat e saj i ka në vitin 2013. Kjo aleancë është rezultat një lëvizje të filluar nga gratë deputete, me synim nxitjen e barazisë gjinore, në parlament dhe avokimin për përfshirjen e perspektivës gjinore në legjislacion.

### **Aleanca e Grave Këshillëtare**

**2017**

Aleanca Kombëtare e Grave Këshilltare Bashkiake (AKK) dhe 61 Aleancat e Grave Këshilltare Bashkiake në 61 Bashki, që synojnë gjithashtu, zbatimin e politikave mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse për gratë, si dhe arritjen e barazisë gjinore në nivel vendor.

<sup>12</sup>Ligji Nr.10221/2010 <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1308053956-Ligji-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi.pdf>

<sup>13</sup>Ligji Nr. 9699/2006 <http://www.parlament.al/Files/Akte/ligj%20nr.%2047,%20dt.%2023.7.2018.pdf>

## 3.2 Strukturat e Partive Politike për Arritjen e Barazisë Gjinore & Perspektiva Gjinore e Organizimit dhe Rregulloreve të Brendshme të Partive Politike në Shqipëri – Pasqyra e Statuteve të Partive Politike

Partitë politike në vendin tonë, e bazojnë aktivitetin e tyre në ligjin **8580, datë 17.2.2000**<sup>14</sup>. Sipas këtij ligji, partitë politike, **“janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit”**.

Më tej, ligji kërkon që krijimi i partive politike të bazohet në vlerësimin e programit, statutit ose rregullores së partisë (neni 8), ku edhe specifikohet emërtimi, qendra, qëllimet, detyrat, burimet e financimit, si dhe “organet udhëheqëse e ndërtimi i partisë” (neni 9, pika c). Pra organizimi dhe funksionimi i brendshëm i forcave politike është një proces.

Partitë politike janë të organizuara në parimet demokratike, në statutet dhe dokumentat kryesore të brendshme. **Rëndësia e statutit mbetet e madhe për partitë politike, njohja dhe respektimi i tij mbeten sfidë.**

Disiplina e brendshme, liria e mendimit, kolegjaliteti, iniciativa personale dhe vetëveprimi, transparenca e vendimmarrjes në të gjitha nivelet, konkurrenca e vlerave dhe sistemi i meritokracisë, shkalla e centralizimit/decentralizimi në vendimmarrje, pavarësia nga ndikimet e panevojshme dhe genia përgjegjës përpara bazës së tyre dhe popullatës së gjerë, ekzistenca dhe zbatimi i procedurave të ankesave, etj, janë disa nga parimet kryesore të funksionimit dhe të ekzistencës së partive politike.

Partitë politike kanë rol vendimtar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe rrjedhimisht edhe në promovimin e vlerave demokratike. Përfshirja e grave në politikë dhe vendimmarrje, si dhe vendosja e tyre në pozita udhëheqëse në masë të madhe, varet nga partitë politike. Gratë në pozita vendimmarrëse, përbëjnë faktorë të rëndësishëm, në krijimin e politikave më të mira që ndikojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave, në veçanti, dhe në atë shoqërore në përgjithësi. Angazhimi për përfaqësim më të barabartë në institucione, ndikon drejtpërdrejtë në zvogëlimin e padrejtësive dhe rritjen e kohezionit shoqëror.

Si rrjedhim, për të përfituar një panoramë të plotë të perspektivës gjinore, në strukturat e partive politike, nëpërmjet dokumentave kryesore të tyre dhe eksperiencat e përfaqësimit të grave në politikë dhe në strukturat brenda partive politike, iu referuam tre partive kryesore në Shqipëri, të cilat kanë dhe numrin më të lartë të anëtareve dhe numrin më të lartë të mandateve në parlamentin Shqiptar, PS, PD dhe PL.

<sup>14</sup>[https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020\\_1.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020_1.pdf)

### 3.2.1 PARTIA SOCIALISTE <sup>15</sup>

Partia Socialiste (PS), si subjekt kushtetues, vepron sipas ligjit organik mbi partitë politike. Në spektrin politik shqiptar PS është partia më e madhe e së majtës në Shqipëri dhe partia me numrin më të lartë të anëtarësisë.

Sipas statutit të saj, **Partia Socialiste, (PS)** është parti politike e cila bazohet në parimet e lirisë, drejtësisë sociale, barazisë së shanseve dhe solidaritetit njerëzor; liritë dhe të drejtat themelore të njeriut si të drejta të të gjithë qytetarëve; pluralizmin politik dhe zgjedhjet e lira dhe të ndershme; përgjegjësinë për promovimin e mundësive të barabarta për gratë, vajzat dhe rininë dhe mbrojtjen e veçantë të këtyre grupeve të shoqërisë, si dhe të fëmijëve e të moshuarve; respektimin e Kushtetutës, akteve ndërkombëtare dhe të ligjeve të Republikës së Shqipërisë; forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe garantimin e një qeverisjeje të përgjegjshme si kontratë mes qytetarësh të lirë, decentralizimin si një ekuilibër midis qeverisjes eficiente qëndrore.

Statuti i PS, është akti themelor ku përfshihen parimet dhe normat, sipas të cilave ndërtohet dhe funksionon partia. Ai parashikon dhe rregullon organizimin e partisë, në nivel vendor dhe atë qendror. Ndërsa për pjesën më të madhe të rregullave procedurale, kriterëve dhe proceseve që rregullojnë marrëdhëniet dhe zgjedhjet në të gjitha nivelet, rregullohen me akt të veçantë, që quhet Libri i Rregullave, në përputhje me Statutin.

Organet dhe drejtuesit e partisë, zgjidhen përmes një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent, në përputhje me Statutin e Partisë, Librin e Rregullave dhe udhëzimet e organeve vendimmarrëse përkatëse<sup>16</sup>.

**Neni 8/6** i Statutit parashikon:

Dokumentet themelore të Partisë Socialiste janë: 1. Programi, 2. Statuti dhe 3. Libri i Rregullave i cili është dokumenti ku përfshihen idetë, parimet, strategjia dhe vizioni politik i partisë<sup>17</sup> (Neni 11). Programi realizohet përmes veprimtarisë politike dhe programeve qeverisëse në nivel qëndror e vendorë.

**Neni 3, pika 4**, saktëson se PS garanton shanse të barabarta në përfaqësimin midis grave dhe burrave<sup>18</sup>.

Një risi në ndryshimet e fundit të Statutit të Partisë në vitin 2022, është që përkrahësi i Partisë Socialiste, pajiset me kartën "Përkrahës i PS". Kartën e përkrahësit të Partisë Socialiste, e jep kryetari i partisë i bashkisë, sipas kërkesës së të interesuarit dhe rekomandimit për anëtaresim të ardhur nga OS-së, FRESH-it dhe FGS-së<sup>19</sup>. Kjo risi rrit mundëinë e angazhimit pranë partisë edhe të grave dhe vajzave që nuk janë anëtare, por që mund të kontribuojnë si përkrahëse në mënyra të ndryshme.

<sup>15</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022

<sup>16</sup>Statuti i Partisë Socialiste, Pjesa e I, Kreu I, neni 8, pika 6, faqe 9

<sup>17</sup>Statuti i Partisë Socialiste, Kreu II, neni 11, faqe 10

<sup>18</sup>Statuti i Partisë Socialiste, Kreu I, neni 3, faqe 8

<sup>19</sup>Statuti i Partisë Socialiste, Pjesa e II, Kreu 3, neni 20, pika 2, faqe 14

Gjithashtu një qasje e re dhe tregues pozitiv, që tregon për një zhvillim, në lidhje me barazinë gjinore, në strukturat e partisë, është dhe një nga ndryshimet e fundit të statutit të PS, ku theksohet se çdo Organizatë Socialiste (OS) duhet të drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një për secilën gjini<sup>20</sup>, (**neni 23, pika 7**), pra çdo OS, duhet të drejtohet nga një kryetar burrë dhe një kryetare grua, që janë emërtuar **bashkëkryetarë**. Ky parim parashikohet të zbatohet edhe në nivelet e tjera të strukturës së PS.



Në **nenin 23** të Statutit, trajtohet formimi i njesisë bazë organizative dhe elektorale, që është Organizata Socialiste (OS). Sipas këtij neni, është përcaktuar se OS, duhen të ngrihen, duke u mbështetur në parimin e pjesëmarrjes dhe drejtimit me jo më pak se 30%, për secilën gjini, (pika 3, germa b)<sup>21</sup>;


**Neni 23/7.** Veprimtaria e Organizatës Socialiste, drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një për secilën gjini dhe sekretar-i/ët. Grupi i anëtarëve të partisë zgjedh një sekretar<sup>22</sup>.

**Neni 23/8.** Në çdo Organizatë Socialiste ngrihet e vepron grupi i të rinjve të FRESH-it dhe grupi i FGS-së<sup>23</sup>.

**Neni 33/2.** Delegatët e zgjedhur votohen nga anëtarësia e partisë, sipas parimit “një anëtar, një votë” dhe bazuar në normën e përfaqësimit të miratuar nga Asambleja Kombëtare, për çdo njësi administrative. Lista e kandidatëve për t’u votuar dhe lista e fituesve si delegatë duhet të sigurojnë një përfaqësim të barabartë prej 50% për secilën gjini. Në çdo listë, 10 për qind e tyre janë të rinj dhe të reja të moshës deri 30 vjeç<sup>24</sup>.

**Neni 34/pika 4, germa b.** Kongresi zgjedh me votim të fshehtë kandidatura alternative për anëtarë të Asamblesë Kombëtare. Votimi për kandidaturat shoqe për anëtarë të Asamblesë Kombëtare bëhet me listë të veçantë. Kandidaturat Shoqe përbëjnë jo më pak se 50 për qind të listës për anëtarë të Asamblesë Kombëtare Kongresi zgjedh KGSE – Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikes.<sup>25</sup>

**Neni 37, pika 3, paragrafi 4,** parashikon se: Lista e kandidatëve për t’u votuar dhe lista fituese, për Asamblenë Kombëtare, duhet të sigurojë një përfaqësim jo më pak se 40% të secilës gjini. Votimi për çdo gjini bëhet me listë të veçantë. Ndërsa 10% sigurohet nga anëtarët e FRESH-it<sup>26</sup>.



Në Statutin e PS, në nenin 45, në parimet e zgjedhjes së përfaqësuesve të partisë, në organet e qeverisjes, përveç kriterëve dhe procedurave, në pikën c. të nenit 45, është e përcaktuar se: **në përzgjedhjen e kandidatëve, duhet të zbatohet parimi i barazisë midis burrave dhe grave**<sup>27</sup>.

<sup>20</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 5, neni 23, pika 7, faqe 15

<sup>21</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 5, neni 23, pika 3, faqe 15

<sup>22</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 5, neni 23, pika 7, faqe 15

<sup>23</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 5, neni 23, pika 8, faqe 16

<sup>24</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 6, neni 33, pika 2, faqe 19

<sup>25</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 6, neni 34, pika 4, faqe 20

<sup>26</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 6, neni 37, pika 3, faqe 22

<sup>27</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e IV, Kreu 7, neni 45, germa c, faqe 28



## Neni 64



- 1. Forumi i Gruas Socialiste të Shqipërisë është organizëm politik, i cili bashkon vajzat dhe gratë anëtare dhe përkrahëse të partisë me synim nxitjen dhe rritjen e aksesit dhe kontributit të grave dhe vajzave në parti.*
- 2. Programi dhe veprimtaria e FGSSh-së konvergjojnë me Programin, Statutin dhe veprimtarinë e partisë.*
- 3. FGSSh-ja ndërton strukturat e veta në nivel vendor e qendror. Drejtueset e FGSSh-së, duhet të jenë anëtare të partisë dhe hyjnë drejtpërdrejtë në përbërje të organeve drejtuese të niveleve përkatëse të partisë.*
- 4. PS ngre/bashkëpunon edhe me grupe apo struktura të grave të ngritura mbi baza interesi, profesioni apo iniciativa sociale e politike.*
- 5. Parimet kryesore, rregullat e përgjithshme organizative e procedurale, funksionimi dhe përbërja e organeve drejtuese të FGSSh-së përcaktohen nga statuti.*

## **Neni 47- Kodi i Etikës**<sup>29</sup>

Partia Socialiste ka dhe Kodin e Etikës, në të cilin përmbledhen kriteret e komunikimit dhe marrëdhënieve etike, brenda strukturave të partisë dhe në komunikimin me zgjedhësit, standardet e integritetit moral dhe etik, që duhet të përmbushë çdo kandidat, gjatë ushtrimit të mandatit të tij, si përfaqësues i Partisë Socialiste, për organet qendrore e vendore. Në këtë Kod përcaktimet janë të përgjithshme dhe nuk gjenden parashikime të veçanta të lidhura me gjinitë. Duke iu referuar neneve të statutit të sipërcituara vërehet se PS i ka dhënë hapësirë dhe rëndësi përfaqësimit të grave në strukturën e partisë dhe në strukturat vendimmarrëse të pushtetit vendor dhe qendror. Ky është një tregues pozitiv, por në pjesën e dytë të këtij studimi do të hulumtohet nëse ka mbetur në nivele formale, apo ka krijuar realisht kushte më të favorshme për zbatimin e aksesit dhe barazisë gjinore brenda partisë?

Gjithashtu nga statuti vërehet se PS ka një organizim të përhershëm, nga njësia bazë, që është organizata socialiste që drejtohet nga dy bashkëkryetarë nga secila gjini. Për delegatet e Kongresit, lista e fituesve si delegatë, duhet të sigurojë një përfaqësim prej 50% për secilën gjini. Ndërsa për Asamblenë Kombëtare, lista e kandidatëve dhe lista e fituesve duhet të sigurojë jo më pak se 40% të përfaqësimit për secilën gjini.

<sup>28</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e VI, Kreu 12, neni 64, faqe 35

<sup>29</sup>Statuti i Partisë Socialiste 09.04.2022, Pjesa e III, Kreu 5, neni 23, pika 7, faqe 15

## 3.2.2 PARTIA DEMOKRATIKE

*Shënim Sqarues:* Në këtë seksion janë shqyrtuar dy statute, pasi Partia Demokratike që prej vitit 2021, funksionon aktualisht e ndarë në dy pjesë, të cilat janë në proces gjyqësor për të përcaktuar cila prej tyre (dhe rrjedhimisht cili prej statuteve) njihet zyrtarisht si ai i Partisë Demokratike.

### 1. Në Statutin e Partisë Demokratike referohet si në vijim:

Partia Demokratike, (PD) është parti politike, ku qëllimet politike dhe vlerat themelore politike detajohen dhe pasqyrohen në programin e saj, si dhe në dokumente të tjera që miratohen në perputhje me Statutin e Partisë.

Statuti i PD, përcakton parimet dhe vlerat themelore politike, kriteret e posaçme, për çdo funksion politik, brenda partisë apo përfaqësim politik në organet qendrore apo lokale, ndërsa rregullat që garantojnë një proces demokratik përcaktohen në aktet nën-statutore.

*Funksionimi i PD, bazohet në shance të barabarta në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe burrave, duke synuar dhe nxitur, që në çdo organ apo nivel, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave, të jetë jo më pak se 30% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në atë organ apo nivel përfaqësimi<sup>31</sup>.*

**Neni 34, germa ë),** siguron se përfaqësimi i të zgjedhurve prej organizatës LDG (Lidhja Demokratike e Gruas), në Kuvendin e Degës së PD, i cili është organi më i lartë vendimarrës, është deri në 5% e numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve.<sup>32</sup>

**Neni 35, germa e),** përcaktohet se në Kryesinë e Degës së Partisë, zgjidhet dhe Kryetarja Vendore e LDG.<sup>33</sup>

**Neni 43, germa ë),** në Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike, zgjidhen një numër i kufizuar përfaqësuesish të organizatave partnere në numër të barabartë, LGD dhe FRPD (Forumi Rinor i Partisë Demokratike), e cila duhet të jetë jo më shumë se 5% e numrit të anëtarëve të tjerë të Kuvendit.<sup>34</sup>

**Neni 44 - pika 3),** gjithashtu përcakton që numri i anëtarëve të zgjedhur në Këshillin Kombëtar, nga gjinia më pak e përfaqësuar, të mos jetë më pak se 30%, Nëse kuotat, nuk plotësohen nga renditja e dalë pas votimit, atëhere renditja e tyre, veçohet nga ajo e përgjithshmja.<sup>35</sup>

**Neni 45 pika 2, germa e),** përcaktohet se numri i anëtarëve të zgjedhur në Kryesinë e PD, të mos jetë më pak se 30%, nga gjinia më pak e përfaqësuar.<sup>36</sup>

<sup>30</sup>Statuti i Partise Demokratike 18.12.2021 <https://pd.al> – drejtuar nga Z. Enkelejd Alibeaj

<sup>31</sup>Statuti i Partise Demokratike Kreu II, neni 9, pika 5

<sup>32</sup>Statuti i Partise Demokratike Kreu III, neni 34, germa ë

<sup>33</sup>Statuti i Partise Demokratike Kreu III, neni 35, germa e

<sup>34</sup>Statuti i Partise Demokratike Kreu V, neni 43, germa ë

<sup>35</sup>Statuti i Partise Demokratike Kreu V, neni 44, pika 3

<sup>36</sup>Statuti i Partise Demokratike Kreu V, neni 45, pika 2, germa e

## Neni 58 - Organizatat Partnere

PD është e përbërë dhe nga organizatat partnere si<sup>37</sup>:

a) Forumi Rinor neni 58/a

b) Lidhja Demokratike e Gruas (LDG) neni 58/b

Parimet bazë të strukturës së LDG, janë të ngjashme me ato të PDSH. Miratimi i Statutit të organizatave partnere, ndjekja në vijimësi e zbatimit të tij, bëhet nga Kryesia e Partisë (neni 58, pika 3-4)

PD mbështet veprimtarinë politike të organizatave partnere dhe garanton përfaqësimin e organizatave partnere në të gjitha nivelet e përfaqësimit politik, ku LGD, është në standartin minimum, të parashikuar në ligj. (neni 58. Pika 3).

## 2. Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë 11.12.2021<sup>38</sup>

Partia Demokratike e Shqipërisë (PDSH), është një organizëm politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë, në strukturat e saj, të organizuara në nivel kombëtar dhe vendor.

Funksionimi i PDSH, funksionin duke u bazuar në vlera, si demokracia e brendshme, liria e shprehjes, kolegjaliteti etj, si dhe në shanse të barabarta në pjesmarrjen dhe përfaqësimit midis grave dhe burrave, duke synuar dhe nxitur, që në çdo organ apo nivel, pjesmarrja dhe përfaqësimi i grave, të jetë jo më pak se 30% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në atë organ apo nivel përfaqësimi<sup>39</sup> sipas **Nenit 9, pika 7**.

PDSH, ka për qëllim të promovojë respektimin e barazisë gjinore në jetën e partisë dhe pjesmarrjen e grave në organe të zgjedhura dhe ato ekzekutive, sipas **nenit 3, pika 4, germa e**.<sup>40</sup>

Gjithashtu në **nenin 31, gërma g)** përcaktohet se: përfaqësues të zgjedhur prej organizatave partnere, LDG dhe FRDSH, në Kuvendin e Degës, duhet të jenë deri në 10%, të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të zgjedhur për në Kuvendin e Degës.<sup>41</sup>

**Neni 32, gërma a)** saktëson se: në Kryesinë e Degës, me të drejta të plota, përfshihen edhe Kryetarët Vendorë të LDG dhe FRDSH.<sup>42</sup>

**Neni 32, gërma c)**, përcakton se: numri i zonjave fituese, të mos jetë më pak se 30% e numrit të anëtarëve të Kryesisë, që del prej votimit. Në raste se ky kriter nuk plotësohet në renditjen e dalë prej votimit, atëherë renditja e tyre, veçohet nga e përgjithshmja, deri në plotësimin e numrit të kërkuar.<sup>43</sup>

<sup>37</sup>Statuti i Partise Demokratike, Kreu VII, neni 58

<sup>38</sup>Statuti i Partise Demokratike <https://pdsh.al> – Drejtuar nga Z. Sali Berisha

<sup>39</sup>Statuti i Partise Demokratike te Shqiperise 11.12.2021 <https://pdsh.al>

<sup>40</sup>Statuti i Partise Demokratike, Kreu I, neni 3, pika 4, germa e, faqe 3

<sup>41</sup>Statuti I Partise Demokratike te Shqiperise, Kreu I, neni 9, pika 7, faqe 5

<sup>42</sup>Statuti I Partise Demokratike te Shqiperise, Kreu III, neni 32, germa a, faqe 16

<sup>43</sup>Statuti i Partise Demokratike te Shqiperise, Kreu III, neni 32, germa c, faqe 16

**Neni 42, gërma dh)** përcakton: një numër përfaqësuesish të organizatave partnere me numër të barabartë, jo më shumë se 10% e numrit të anëtareve të tjerë të zgjedhur në Kuvendin Kombëtar.<sup>44</sup>

**Neni 44, pika 3** përcakton se: numri i anëtareve të zgjedhur në Këshillin Kombëtar, nga gjinia më pak e përfaqësuar, nuk duhet të jetë më pak se 30%. Në raste se ky kriter nuk plotësohet në renditjen e dalë prej votimit, atëherë renditja e tyre, veçohet nga e përgjithshmja, deri në plotësimin e numrit të kërkuar<sup>45</sup>.

**Neni 47, gërma e)** përcakton se: në Kryesinë e Partisë, jo më pak se 30% e anëtareve të zgjedhur të Kryesise, duhet të jetë gjinia më pak e përfaqësuar<sup>46</sup>.

**Neni 58** - Organizatat Partnerë:<sup>47</sup>

### Neni 58

PD është e përbërë dhe nga organizatat partnere si

- a) Forumi Rinor i Partisë Demokratike neni 58/a
- b) Lidhja Demokratike e Gruas (LDG) neni 58/b
- c) Grupimi i "Dhjetor '90".

Parimet bazë të strukturës së tyre, janë të ngjashme me ato të PDSH. Miratimi i Statutit të organizatave partnere, ndjekja në vijimësi e zbatimit të tij, bëhet nga Kryesia e Partisë. PDSH mbështet veprimtarinë politike të organizatave partnere, në të gjithë territorin e vendit si dhe e garanton përfaqësimin e tyre, në të gjitha nivelet e përfaqësimit politik, ku LGD, respekton standartin minimum, të parashikuar në ligjin elektorale (neni 58. Pika 2/ 3).

Si përmbledhje, Statuti i PD përcakton një kuotë 30% për përfaqësimin e grave në Komitet Drejtues dhe në Këshillin Kombëtar të Partisë. Përveç kësaj ekziston një forum i grave, LDG i cili është i ngarkuar me përfaqësimin e interesave të anëtarëve, në të gjitha strukturat e partisë. Statuti i PD, thekson se funksioni i forumit të grave është të nxisë pjesëmarrjen e grave në politik-bërje, në strukturat vendimarrëse të partisë dhe angazhimin e tyre në funksionet politike, por nuk ka parashikime në lidhje me financimin dhe funksionimin e tij. Në nenin 55 të Statutit të PD, për Financat e partisë, nuk specifikohet se si do të financohet LGD.

### Neni 44



**Përfaqësimi**

<sup>44</sup>Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Kreu IV, neni 42, gërma dh, faqe 21

<sup>45</sup>Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Kreu IV, neni 44, pika 3, faqe 23

<sup>46</sup>Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Kreu IV, neni 47, gërma e, faqe 25

<sup>47</sup>Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Kreu VII, neni 58, faqe 30

### 3.2.3 PARTIA E LIRISË

**Statuti i Partisë së Lirisë përcakton se PL** është parti politike me ideologji social-demokrate, me karakter elektoral, me organizim vertikal nga baza në qendër, që ushtron aktivitetin e saj, në të gjithë territorin e vendit dhe është e organizuar në dy nivele, vendor dhe qendror. Në themel të saj ka demokracinë e brendshme në parti, lirinë e shprehjes dhe të besimit, të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, sipas parimit "një anëtar një votë".

Dokumentat bazë të Partisë së Lirisë, janë Programi dhe Statuti i PL<sup>48</sup>.

Në kreun XVII të Statutit - Organizatat Partnere, në nenin 17.2 është e përcaktuar se: *Anëtarët e Lëvizjes Rinore për Integrim (LRI) dhe Lëvizjes së Gruas për Integrim (LGI), janë automatikisht anëtare të PL, nëse plotësojnë kriteret e vendosura në statut.*<sup>49</sup>

Ndërsa në nenin 17.3 përcaktohet se: *Lëvizja e Gruas për Integrim, përfaqësohet me lista të veçanta kandidimi për forumet e PL, në të gjitha nivelet, duke respektuar parimin e barazisë gjinore. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet edhe në përbërjen e të gjitha forumeve të PL-së.*

Në nenin 17.5 shprehet se; Përfshirja në forumet e PL-së, me kuota të caktuara, nuk pengon kandidimin dhe zgjedhjen e përfaqësuesve të këtyre dy organizatave, të rinjve e të rejave apo grave, në forumet e PL-së, jashtë këtyre kuotave.

Neni 17.6 përcakton se; Në buxhetin e PL-së, parashikohen zëra më vete për Lëvizjen e Gruas për Integrim dhe për Lëvizjen Rinore për Integrim.

Si përmbledhje, statuti i PL, ka një dispozitë, e cila parashikon së Lëvizja e Gruas për Integrim, përfaqësohet në të gjitha nivelet në masën jo më pak se 50% (neni 17). Gjithashtu, për LGI ka një linjë buxhetore të përcaktuar, një shembull i mirë, megjithëse nuk ka të specifikuar burimin e financimit të kësaj linje buxhetore dhe funksionimin e saj.

<sup>48</sup>Statuti i Partisë së Lirisë, Kreu V, pika 5.1, <https://partiaelirise.al/sta/>

<sup>49</sup>Statuti i Partisë së Lirisë, Kreu XVII, pika 17.2/3/5/6

**Nisur sa më sipër, duke iu referuar Statuteve për çdo subjekt politik, vërehet se:**

- Përfshirja e prespektivës gjinore në dokumentat kryesore të tyre, ka një përmirësim të dukshëm, duke synuar t'i japë një dimension integral në hartimin e politikave dhe programeve, në krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta.

- Statutet e partive janë hartuar duke respektuar Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe ligjet me fokus gjinor, por mbetet një sfidë në njohjen dhe zbatimin e tyre, që mos të mbeten thjesht në letër dhe sipërfaqësore. Ato duhet të njihen dhe të zbatohen nga të gjithë anëtarët e partive jo vetëm që gratë dhe vajzat të përfitojnë, por edhe që barazia dhe perspektiva gjinore të përfshihen në mënyrë të efekshme në hartimin e politikave më të mira publike dhe sociale si edhe në krijimin e programeve dhe implementimin e projekteve. Kjo është e një rëndësie të veçantë pasi rritja e numrit të grave, përcakton përgjegjësinë gjinore në vendimarrje si dhe krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të qëndrueshme.

- Në një përmbledhje nga rishikimi i dokumentave dhe rregullore të ndryshme brenda partive politike rezulton se në dokumentat kryesore gjenden vlerat, parimet dhe parashikimet e përgjithshme mbi barazinë gjinore, por në disa raste mungojnë dokumenta ose politika specifike për adresimin e çështjeve të veçanta si dhuna me bazë gjinore në politikë, aksesin në financa, etj.

	PS	PD	PL
Vlerat dhe parimet e barazisë gjinore të cituara në statut apo në dokumente të tjera.	✓	✓	✓
Masa të veçanta (kuota ose vende të rezervuara) për të siguruar përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në Kryesi, në Komisionet Ekzekutive, në Komitetet dhe Komisionet brenda partisë, etj.	✓	✓	✓
Komision për barazinë gjinore brenda partisë.	✗	✓	✗
Program i barazisë gjinore i partisë politike.	✗	✓	✗
Protokoll për parandalimin dhe ndërhyrjen kundër ngacmimeve dhe dhunës seksuale brenda partisë politike.	✗	✓	✗
Masa të veçanta ose programe dhe politika për rekrutimin e grave dhe vajzave të reja në partinë politike.	✓	✗	✗
Masa ose programe të ndërmarra për mbështetjen e qëndrueshme të grave dhe vajzave kandidate brenda partisë.	✗	✗	✗
Burime financiare të veçanta të alokuara për forumin dhe strukturat e grave brenda partisë politike.	✗	✗	✓
Burime financiare të veçanta të alokuara për gratë Kandidate në zgjedhje.	✗	✗	✗

Tabela 1 – Rregullore, dokumenta dhe politika për barazinë gjinore brenda partive politike

Me gjithë ndryshimet dhe përmirësimet në statute, ka vend për përmirësime dhe mbetet ende punë për të bërë në lidhje me demokracinë funksionale, aksesin e barabartë në burime dhe financa, etj, të cilat dalin në pah në vijim të këtij studimi dhe mund të adresohen përmes rekomandimeve të tij.

## 4. Përfaqësimi i Vajzave dhe Grave

në Listat e Kandidatëve në Partitë e Ndryshme Politike  
– Zgjedhjet Parlamentare & Vendore 2003 – 2023

Pasqyra e mësipërme e parashikimeve statutove në lidhje me barazinë gjinore parashtrojnë një situatë formalisht pozitive të ndryshimeve që kanë ndodhur në lidhje me barazinë gjinore brenda partive politike. Të gjitha këto përmirësime të legjislacionit dhe dokumenteve bazë të partive politike, përfaqësojnë një mënyrë të garantimit të suksesit në garën politik dhe mund të kenë efekte pozitive mbi mendimin politik. Por për të kuptuar se cilat kanë qënë realisht trendet e përzgjedhjes dhe përfaqësimit të grave dhe vajzave në listat për Zgjedhjet Parlamentare dhe Zgjedhjet Vendore në vitet 2003 – 2023, nga të dhënat në faqen e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, është kryer një përmbledhje e kandidatëve gra dhe burra nga partitë e ndryshme politike.

Nga të dhënat rezultojnë se Partia Socialiste e Shqipërisë ka patur një tendencë më të theksuar ndër vite për të vendosur në listat e kandidatëve më shumë vajza dhe gra, e pasuar nga Partia e Lirisë dhe Partia Demokratike. Vendosja në listat e kandidatëve ka rezultuar edhe në më shumë gra të zgjedhura si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor.<sup>50</sup>

Zgjedhjet Parlamentare 2001 - 2021

# 2001




Figura 1 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2001

<sup>50</sup><https://kqz.gov.al/>

# 2005

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	94	4	53	3
PS	90	8	38	4
LSI	92	8	5	0
PR	94	4	10	1
PSD	89	18	5	2
PDR	91	8	4	0
PAA	90	6	4	0
AD	83	7	3	0
PBDNJ	82	2	2	0
PDK	41	4	2	0
PDSSH	95	5	2	0
BLD	88	12	1	0
I Pavarur	9	2	1	0




Figura 2 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2005

# 2009

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	105	39	59	10
PS	109	34	52	13
LSI	98	42	4	0
PR	104	37	1	0
PBDNJ	60	41	1	0




Figura 3 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2009



# 2013

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	106	44	47	10
PS	115	38	50	15
LSI	92	48	13	3
PDIU	86	51	4	0
PR	171	81	3	0
PKD	90	42	1	0
PBDNJ	76	43	1	0




Figura 4 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2013

# 2017

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	153	41	32	11
PS	104	52	53	21
LSI	87	59	15	4
PDIU	81	63	2	1
PKD	89	54	1	0




Figura 5 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2017

# 2021

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD / AN	102	51	42	18
PS	94	59	46	28
LSI	92	61	2	2
PSD	90	63	2	1





Figura 6 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2021



Grafiku 1 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike ndër vite Zgjedhjet Parlamentare 2001 - 2021

2003

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD+PR+PBL	60	0	23	0
PS	59	1	33	0
PBDNJ	22	3	2	0
PDS	44	1	1	0
PLL	3	2	0	0
PSD	32	2	0	0
PDR	31	2	0	0
I Pavarur	19	1	0	0
PBK	16	0	0	0
PDK	12	0	0	0
PKSH	10	0	0	0
PSH	9	0	0	0
PBD	3	0	0	0
PBKD	3	0	0	0
PESH	2	0	0	0
PAP	2	0	0	0
Pkons	2	0	0	0
PSHA	1	0	0	0
PRDSH	1	0	0	0
PKDSH	1	0	0	0
PMP	1	0	0	0
PSKSH	1	0	0	0
PASSH	1	0	0	0
PBKDSH	1	0	0	0

Figura 7 – Përfaqësimi i Vajzave &amp; Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2003

380

Kandidatë/e

24

Parti

12

Kandidate Gra


0

Gra të Zgjedhura

# 2007

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	42	0	23	0
PS, LSI, PSD, PDS, AD	51	4	25	1
PD, PR	9	0	5	0
PD, PAA	3	0	1	0
PKSH	16	0	0	0
PBDNJ	11	0	3	0
I Pavarur	27	1	0	0


Figura 8 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2007



# 2011

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	49	2	28	0
PS	63	2	32	2
LSI	11	0	2	0
PR	2	0	1	0
PBDNJ	1	0	0	0
LZHK	1	0	0	0
PKSH	1	0	0	0
PÇSH	1	0	0	0
I Pavarur	2	1	0	0

Figura 9 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2011




# 2015

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
APPD*	59	3	13	2
ASHE*	45	13	38	8
PBDNJ	5	0	0	0
PFM	2	0	0	0
AP	3	0	0	0
I Pavarur	13	1	0	0

\*APPD (PD, PR, PAA, PLZHK, PBKD, PKSH, PPKD, PBD, PDRE & PLDSH)

\*ASHE (PS, LSI, FRP, PSV91, PADSH & PUK)

Figura 10 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2015




# 2019

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD*	0	0	0	1
PS	53	8	52	8
BD	17	3	0	0
PKSH	2	0	0	0
MEGA	1	0	1	0
SHN	4	0	0	0
PKKA	1	0	0	0
AMIE	1	0	0	0
I Pavarur	6	0	0	0

\*Partia Demokratike nuk ka marrë pjesë në Zgjedhjet Vendore 2019.

Pranë Bashkisë Shkodër ka vijuar në drejtim Kryetarja e Bashkisë znj. Voltana Ademi



Figura 11 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2019



# 2023

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
BF	58	3	7	0
PS	52	8	45	8
PD	11	3	0	0
PDIU	0	1	0	0
FRONTI I MAJTË	1	0	0	0
LËVIZJA BASHKË	1	0	0	0
MEGA	1	0	1	0
PEISH	1	0	0	0
LËVIZJA E RE	1	0	0	0
I Pavarur	2	0	0	0


Figura 12 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2023




Grafiku 1A – Përfaqësimi i Vajzave & Grave si Kandidate për Kryetare Bashkie në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore 2003 - 2023

Nga ana tjetër vihet re se veçanërisht në rastet e pushtetit vendor në proceset e kandidimit të vajzave dhe grave si kandidatë për kryetare bashkie, një përqindje e lartë e atyre që vendosen si kandidatë, fitojnë, pra votohen nga komunitetet përkatëse, përtej mitit që gratë dhe vajzat kanë më pak shanse të votohen në sistem mazhoritar apo listat të hapura kandidatësh.

Grafiku i mëposhtëm, që përbëhet nga % e grave dhe vajzave kandidatë dhe përqindja e grave të zgjedhura tregon qartë se kur grave dhe vajzave u jepet mundësia për të qënë kandidatë në procese më sistem mazhoritar (ose lista të hapura) një përqindje e lartë e tyre zgjidhen. Kjo tregon se mungesa e grave në këto pozicione, nuk ndodh sepse nuk fitojnë garat përkatëse, por sepse nuk arrijnë të jenë kandidatë të vendosura nga partitë politike.



Grafiku 2 – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Parlamentare 2001-2021



Grafiku 2A – Përfaqësimi i Vajzave & Grave në Listat e Kandidatëve në Partitë e ndryshme politike në Zgjedhjet Vendore për Kryetar/e Bashkie

2003-2023

## 5. Eksperienca dhe Perceptimi

i Grave dhe Vajzave Anëtare të Partive Politike në Shqipëri  
në Lidhje me Barazinë Gjnore Brenda Partive Politike


### 5.1 Gjetjet: Komponenti Sasior – Anketa me Gratë dhe Vajzat Anëtare të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike, Partisë së Lirisë.

Pas informacioneve bazë të përfituara nga rishikimi i statuteve dhe i legjislacionit, për të përmbushur spektrin e informacionit me një bazë më të gjerë, një pyetësor online u krye me 204 gra dhe vajza anëtare të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Partisë së Lirisë për të kuptuar më tej sfidat, mundësitë dhe barrierat e grave brenda partisë politike, dinamikat e proceseve vendimmarrëse dhe strukturat përfaqësuese, akesin e tyre në financa, etj. Kampionimi gjatë kësaj faze u përbë nga një grup heterogjen anëtarësh të partive politike, në pozicione, moshë, prejardhje të ndryshme, përvoja politike, etj.

Një nga problematikat e hasura shpesh në lidhje me dokumentat, politikat dhe informacionet në lidhje me partitë politike është mungesa e informacionit zyrtar dhe të aksesueshëm për partitë në përgjithësi dhe forumet e grave të partive politike, si dhe mungesë të arkivave dhe publikimeve të informacionit lidhur me historikun dhe aktivitetet e realizuara nga Forumet. Për këtë arsye u zhvillua ky një pyetësor online për të vlerësuar barrierat me të cilat përballen gratë dhe vajzat si pjesë e partive politike dhe rekomandimet e tyre për të përmirësuar situatën e barazisë gjnore brenda tyre. Nëpërmjet një pyetësoi të detajuar, vajzat dhe gratë anëtare dhe drejtuese në strukturat e 3 partive politike ndanë eksperiencat e tyre brenda partive, perceptimet dhe përjetimet e tyre, si dhe rekomandime për fuqizimin e mëtejshëm të vajzave dhe grave brenda partive politike.

Të dhëna për pjesëmarrëset në sondazhe:

Nga të dhënat e përgjithshme të pjesëmarrësve në sondazh rezulton se, përqindja më e lartë e grave dhe vajzave të angazhuara në këtë pyetësor është moshë 20 – 40 vjeç. Në kuadër të hulumtimit është realizuar një shpërndarje e qëllimshme e grupmoshave, për të dhënë një perceptim sa më të plotë të



eksperiencave dhe përjetimeve të grave brenda partive politike përtej moshës së tyre. Një aspekt i partive politike shqiptare dhe veçanërisht i forumit të grave që vihet re zakonisht, është që vajzat nën moshën 25 vjeç nuk hyjnë direkt në forumin e grave, por bëhen fillimisht pjesë e forumeve rinore dhe më pas, kur kalojnë moshën 25-30 vjeç mund të fillojnë të angazhohen me forumet e grave brenda partive politike.

Grafiku 3 – Moshë e pjesëmarrësve në pyetësor




Vihet re nga ky sondazh, por edhe nga puna me partitë politike, që gratë dhe vajzat e angazhuara aktivisht në strukturat e ndryshme të partive politike kanë një nivel arsimor mbi mesataren. Kjo tregon një potencial shumë të vlefshëm i cili mund të shfrytëzohet edhe më shumë nga partitë politike, në ekspertizën e ofruar për politikbërjen në fusha të ndryshme.

Një nga eksperiencat që rezultojnë edhe nga fokus grupi i kryer dhe nga puna në terren me partitë politike, është që kapacitetet e grave dhe vajzave profesioniste brenda forumeve dhe partive, rrallë herë përdoren për të rritur më tej kapacitetet e grave dhe vajzave të tjera anëtare.


Përsa i përket statusit civil të pjesëmarrëseve në sondazh, pjesa më e madhe e tyre janë të martuara.

Të dhënat zbulojnë gamën e larmishme të profesioneve midis grave dhe vajzave që marrin pjesë në studim. Shumica e të anketuarave punojnë në fushën e arsimit, gjë që tregon një prani të fortë të arsimtarëve mes pjesëmarrësve aktivë të partive politike. Në vijim janë fushat e ekonomisë/financës, mjekësisë dhe shkencave sociale, të cilat janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë. Kjo sugjeron që një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish kanë formim profesional në këto fusha. Për më tepër, studimi përfshin gra dhe vajza që punojnë në fusha të tjera të ndryshme, duke përfshirë drejtësinë, menaxhimin, gazetarinë dhe komunikimin, inxhinierinë, si dhe fusha të tilla si turizmi, agronomia dhe formime të ndryshme profesionale si studente dhe nëpunëse civile.

Të dhënat nënvizojnë natyrën multidisiplinare të formimit profesional të pjesëmarrësve, duke theksuar përfaqësimin e gjerë të grave dhe vajzave nga sektorë të ndryshëm në studim.




Grafiku 4 – Arsimi i pjesëmarrëseve në pyetësor



Grafiku 5 – Profesioni i pjesëmarrëseve në pyetësor


Të dhënat tregojnë se një shumicë e konsiderueshme e grave dhe vajzave që morën pjesë në studim, 70.6%, raportuan se ushtronin profesionin e tyre ndërkohë që ishin të përfshira në fushën e politikës. Kjo sugjeron që një pjesë e madhe e të anketuarave janë në gjendje të balancojnë përgjegjësitë e tyre profesionale krahas angazhimit të tyre politik. Nga ana tjetër, 29.4% e pjesëmarrëseve kanë treguar se nuk e ushtrojnë profesionin e tyre duke u marrë me politikë. Ky konstatim sugjeron se një pakicë e dukshme grash dhe vajzash mund të marrin vendimin për të pezulluar përkohësisht punën e tyre profesionale në mënyrë që të fokusohen në angazhimet e tyre politike. Të dhënat nxjerrin në pah përvojat e ndryshme të grave dhe vajzave në ushtrimin e profesioneve të tyre dhe përfshirjen politike, duke theksuar nevojën për struktura dhe politika mbështetëse që u mundësojnë individëve të marrin pjesë aktive në politikë, ndërkohë që ndjekin karrierën e tyre. Nga ana tjetër ky fenomen ri-ngre çështjen e përhershme të financimit dhe funksionimit të partive politike, të cilat edhe pse kanë një rol parësor në politikbërjen e vendit, kanë pak mundësi për vetëfinansim, për të mbështetur strukturat, burimet njerëzore dhe kostot për nismat e tyre.



Grafiku 6 – A e ushtrojnë profesionin gratë dhe vajzat gjatë përfshirjes në fushatën politike

Pjesëmarrëset në sondazh deklarojnë se angazhimi i tyre brenda partive politike është rezultat më së shumti i pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme dhe i angazhimit paraprak në forumin e grave. Gjithashtu vihet re se një përqindje e lartë, kanë zgjedhur të aderojnë në partitë politike që i lidhin me traditën e tyre familjare, si kanal nëpërmjet të cilit kanë zgjedhur të aktivizohen në njërin parti apo në tjetrën.

Përgjigjet në pyetjen për kanalin kryesor të hyrjes në parti nxjerrin konstatimet se një shumicë e konsiderueshme, 60.8% e pjesëmarrëseve, raportuan se u bënë pjesë e partisë përmes përfshirjes në forume partiake, si forumet rinore apo forumet e grave. Gjithashtu, 51.5% kanë përmendur se hyrja e tyre në parti ka qenë përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme të organizuara nga partia kryesore. Lidhjet familjare dhe tradita u identifikuan si kanali kryesor nga 44.6% e të anketuarave. Për më tepër, 35.8% kanë përmendur se janë ftuar nga vetë partia politike, ndërsa 9.3% kanë hyrë përmes pjesëmarrjes në trajnime apo akademi politike të organizuara nga OJQ-të. Këto gjetje nxjerrin në pah rrugët e ndryshme përmes të cilave gratë dhe vajzat hyjnë në partitë politike, duke përfshirë forumet si rruga kryesore dhe më efektive, aktivitetet e përgjithshme partiake, lidhjet familjare, ftesat dhe trajnimet e udhëhequra nga OJQ-të. Krijimi i rrugëve gjithëpërfshirëse për pjesëmarrje është thelbësor për të siguruar përfshirjen e grave dhe vajzave në partitë politike dhe gjithashtu nevoja për programe të qëndrueshme të rekrutimit nga ana e partive politike.



Grafiku 7 – Kanali kryesor i hyrjes së grave dhe vajzave në parti

## Pozicionet e emëruara dhe të zgjedhura brenda partive politike:

Të dhënat tregojnë se një shumicë e konsiderueshme e grave dhe vajzave që morën pjesë në studim, 70.6%, raportuan se ushtronin profesionin e tyre ndërkohë që ishin të përfshira në fushën e politikës. Kjo sugjeron që një pjesë e madhe e të anketuarave janë në gjendje të balancojnë përgjegjësitë e tyre profesionale krahas angazhimit të tyre politik. Nga ana tjetër, 29.4% e pjesëmarrëseve kanë treguar se nuk e ushtrojnë profesionin e tyre duke u marrë me politikë. Ky konstatim sugjeron se një pakicë e dukshme grash dhe vajzash mund të marrin vendimin për të pezulluar përkohësisht punën e tyre profesionale në mënyrë që të fokusohen në angazhimet e tyre politike. Të dhënat nxjerrin në pah përvojat e ndryshme të grave dhe vajzave në ushtrimin e profesioneve të tyre dhe përfshirjen politike, duke theksuar nevojën për struktura dhe politika mbështetëse që u mundësojnë individëve të marrin pjesë aktive në politikë, ndërkohë që ndjekin karrierën e tyre. Nga ana tjetër ky fenomen ri-ngre çështjen e përhershme të financimit dhe funksionimit të partive politike, të cilat edhe pse kanë një rol parësor në politikbërjen e vendit, kanë pak mundësi për vetëfinansim, për të mbështetur strukturat, burimet njerëzore dhe kostot për nismat e tyre.

## Kanalet e propozimit në proceset e kandidimit:

Të dhënat tregojnë se një shumicë e konsiderueshme e grave dhe vajzave që morën pjesë në studim, 70.6%, raportuan se ushtronin profesionin e tyre ndërkohë që ishin të përfshira në fushën e politikës. Kjo sugjeron që një pjesë e madhe e të anketuarave janë në gjendje të balancojnë përgjegjësitë e tyre profesionale krahas angazhimit të tyre politik. Nga ana tjetër, 29.4% e pjesëmarrëseve kanë treguar se nuk e ushtrojnë profesionin e tyre duke u marrë me politikë. Ky konstatim sugjeron se një pakicë e dukshme grash dhe vajzash mund të marrin vendimin për të pezulluar përkohësisht punën e tyre profesionale në mënyrë që të fokusohen në angazhimet e tyre politike. Të dhënat nxjerrin në pah përvojat e ndryshme të grave dhe vajzave në ushtrimin e profesioneve të tyre dhe përfshirjen politike, duke theksuar nevojën për struktura dhe politika mbështetëse që u mundësojnë individëve të marrin pjesë aktive në politikë, ndërkohë që ndjekin karrierën e tyre. Nga ana tjetër ky fenomen ri-ngre çështjen e përhershme të financimit dhe funksionimit të partive politike, të cilat edhe pse kanë një rol parësor në politikbërjen e vendit, kanë pak mundësi për vetëfinansim, për të mbështetur strukturat, burimet njerëzore dhe kostot për nismat e tyre.

## Ekspierencat e grave dhe vajzave brenda partive politike

Përsa u përket pengesave kryesore për angazhimin në politikë dhe brenda partive politike, pjesëmarrësit në sondazh deklarojnë se një nga vështirësitë më të mëdha është aksesimi në financat e partisë, më pas mungesa e mbështetjes dhe rritjes së kapaciteteve për të nisur dhe vijuar karrierën në politikë. Sipas përgjigjeve të pyetësorit, u identifikuan disa faktorë ndikues që pengojnë gratë të bëhen pjesë e politikës aktive. Mungesa e mbështetjes financiare nga partia politike dhe qasja e kufizuar në burime u përmendën si barrierat më të rëndësishme, ku 91 të anketuara deklaruan se ka shumë ndikim dhe 76 të anketuara përmendën se ka ndikim. Përveç kësaj, mungesa e mundësive dhe e përkushtimit për të identifikuar, trajnuar dhe mentoruar gratë kandidatë për poste publike u njoh si një faktor pengues, ku 69 të anketuara deklaruan se ka shumë ndikim dhe 106 të anketuara tregojnë se ka ndikim. Mungesa e mbështetjes nga burrat brenda partisë politike, mentaliteti patriarkal mungesa e demokracisë së brendshme partiake dhe kultura seksiste në partitë politike u identifikuan gjithashtu si pengesa me ndikim në aktivizmin politik të grave.


Dy nga gratë e intervistuar shprehen si në vijim:

“


“Nëse grave u jepen kuotat, por jo akses i barabartë në burime dhe financa, atëherë kjo barazi mbetet vetëm në letër!”

Kur nuk reagojmë ndaj dhunës kundër grave në politikë, si presim që vajzat dhe gratë e tjera të prekura nga dhuna të reagojnë?”

”



Grafiku 8 – Ndikimi që kanë disa tregues në frenimin/pengimin e grave për t’u bërë pjesë e partive politike



Grafiku 9 – Problematikat që gratë dhe vajzat konsiderojnë më sfiduese në politikë

Pas listimit të ndikimeve të barrierave kryesore, të anketuarave iu kërkua të zgjidhnin cilat, sipas tyre, ishin 3 pengesat kryesore për angazhimin e grave në politike dhe si pjesë e partive politike dhe njëra prej këtyre sfidave ishte pikërisht gjinia (sfida më e rëndësishme sipas 52.9% të të anketuarave, është përvoja e të qenit grua e angazhuar në një karrierë politike).

“


Citim: “Është e vështirë të jesh grua në Shqipëri dhe aq më tepër grua në politikë! Ne e kemi marrë përsipër, por sa më shumë pengesa ka, aq më pak gra do të angazhohen politikisht!”

”

Gjithashtu, njësoj si më sipër është mungesa e aksesit në financa dhe mungesa e mbështetjes dhe qëndrueshmërisë në karrierën politike. Sfida të tjera të identifikuara përfshinin aksesin e kufizuar në burime dhe financa, me 32.4% që theksohen kufizimet financiare. Një pjesëmarrëse tregon se: “Vështirësia lidhet me burimet financiare, për një grua e cila ka një mal me fatura për të paguar në fund të muajit, ku burrat ose janë pa punë ose shumicën e pagës nuk e sjellin në shtëpi...si mund t'i dedikohesh plotësisht karrierës politike kur nuk ke të ardhura për të mbajtur familjen?”.

Mungesa e stabilitetit dhe avancimi në karrierë në fushën e politikës u theksua gjithashtu si shqetësim kryesor nga 33.3% e pjesëmarrëseve. Një nga problematikat kryesore, shihet edhe demokracia e brendshme e partive politike. Funkionimi i brendshëm partiak, përfshirë demokracinë e brendshme dhe transparencën, u panë si problematike nga 27.5% e pjesëmarrëseve. Përzgjedhja dhe emërimi i kandidatëve gra dhe vajza në listat partiake është identifikuar si sfidë nga 31.9% e të anketuarave, të cilat kanë theksuar mungesën e meritokracisë brenda partive.

18.6% e të anketuarave specifikuan praninë e presioneve dhe dhunës ndaj grave në politikë. Pjesëmarrëset theksuan mjedisin armiqësor, presionet, paragjykimet dhe praninë e një mentaliteti seksist/paragjykues brenda politikës. Në përqindje më të vogla përmendën garat/fushatat zgjedhore (25%) dhe procesi i rekrutimit në parti (16.2%) si sfida shtesë. Këto gjetje nënvizojnë barrierat dhe diskriminimin me të cilin përballen gratë në mjediset politike, duke theksuar nevojën për barazi gjinore dhe praktika gjithëpërfshirëse në mënyrë që të promovohet pjesëmarrja dhe fuqizimi i plotë i grave në proceset vendimmarrëse.



Grafiku 10 – Sa ndikim kanë disa vështirësi brenda partisë tek gratë dhe vajzat pjesë e tyre?

Bazuar në të dhënat e pyetësorit, një analizë e përgjigjeve nxjerr në pah vështirësitë me të cilat përballen personalisht gratë dhe vajzat në partitë politike. Duket qartë se edhe kur nuk flitet më në parim, por zbritet në nivel personal, mungesa e demokracisë së brendshme, meritokracia, aksesit në financa dhe burime, seksizmi, dhuna me bazë gjinore, gjuha e urrejtjes janë disa nga sfidat kryesore me të cilat përballen konkretisht vajzat dhe gratë pjesë e partive dhe e politikës dhe të cilat ndikojnë ndjeshëm në zgjedhjet dhe performacën e tyre.

Gjetjet tregojnë se sjellja/gjuha përçmuese ose ngacmuese ka pasur një efekt ndikues në angazhimin politik të 130 të anketuarave, ku 50 prej tyre e konsiderojnë atë një ndikim të rëndësishëm. Kjo nxjerr në pah se një numër i konsiderueshëm grash dhe vajzash kanë përjetuar një sjellje të tillë, duke ndikuar në nivelin e tyre të angazhimit.

Për sa i përket rregullave dhe normave të pashkruara, 59 të anketuara i identifikuan ato si vështirësi të rëndësishme në pjesëmarrjen e tyre. Për më tepër, 110 të anketuara kanë treguar se kanë pasur ndikim, megjithëse niveli i vështirësisë është i paqartë për to. Në të kundërt, 36 të anketuara nuk e konsiderojnë këtë si një pengesë të madhe. Këto gjetje tregojnë se shumë gra dhe vajza i perceptojnë rregullat dhe normat e pashkruara si pengesa për pjesëmarrjen dhe aksesin e tyre brenda partive politike, ndërsa të tjera mund të mos i shohin ato si barriera të rëndësishme.

Dominimi i burrave brenda partive politike është theksuar nga 127 prej 204 të anketuarave si një problem i shpeshtë që ato hasin. Kjo shumicë tregon se dominimi i burrave është një pengesë e rëndësishme për pjesëmarrjen e plotë të grave dhe vajzave në vendimmarrje brenda partive politike. Ndërsa mungesa e burimeve dhe informacionit mund të ndikojë në angazhimin politik të grave dhe vajzave, 116 të anketuara deklaruan se kjo nuk është një pengesë e madhe. Seksizmi dhe pengesat e lidhura me gjininë u identifikuan nga 50 të anketuara se kishin një ndikim të rëndësishëm dhe 125 të anketuara të tjera pohuan se kishin patur një ndikim në karrierën e tyre politike. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrëseve e shohin seksizmin dhe sfidat e lidhura me gjininë si vështirësi me të cilat përballen gratë dhe vajzat brenda partive politike. Opinionet ishin të ndara për mungesën e aksesit dhe mbështetjes financiare, ku 76 të anketuara thanë se ajo nuk ka shumë ndikim dhe një numër i njëjtë deklaruan se është problem. Kjo nxjerr në pah perspektivat e ndryshme mbi rëndësinë e mungesës së aksesit dhe mbështetjes financiare për gratë dhe vajzat në pjesëmarrjen politike.


Në kategorinë "Të tjera", të anketuarat përmendën vështirësi të tilla si: "Mungesa e mbështetjes nga gratë e tjera brenda strukturave të partisë politike" dhe "Dominimi substancial i burrave brenda partisë, shoqëruar me mungesën e vlerësimit për gratë dhe vajzat". Këto sfida shtesë nënvizojnë nevojën për të adresuar dinamikën e brendshme brenda partive politike, për të promovuar mbështetjen mes grave dhe për të nxitur vlerësimin më të madh për kontributet e grave.

**A mendoni se numri i grave në strukturat e ndryshme të partisë suaj është i mjaftueshëm?**

Perspektivat e pjesëmarrëseve për përfaqësimin e grave në struktura të ndryshme të partisë së tyre politike ishin të ndryshme. Shumica e të anketuarave (58.3%) janë shprehur se numri aktual i grave në strukturat partiake është i pamjaftueshëm, gjë që tregon një çekuilibër të perceptuar gjinor. Nga ana tjetër, 31.9% e konsiderojnë numrin ekzistues të grave si të mjaftueshëm. Një përqindje e vogël (9.8%) mbeti e pasigurt për qëndrimin e tyre për këtë çështje. Komentet e dhëna në lidhje me këtë pyetje hedhin dritë mbi arsyet themelore të këtyre pikëpamjeve. Disa pjesëmarrëse përmendën mbizotërimin e burrave në strukturat partiake si një faktor që kontribuon në perceptimin e pamjaftueshmërisë. Të tjera theksuan nevojën për rekrutim më të madh të grave dhe theksuan barrierat si normat gjinore shoqërore, varësia ekonomike dhe angazhimet familjare. Prania e kuotave u pranua gjithashtu si një faktor kontribues në rritjen e numrit të grave në strukturat partiake, por pjesëmarrëset theksuan rëndësinë e vullnetit të vërtetë politik për të nxitur pjesëmarrjen kuptimplotë dhe gjithëpërfshirëse të grave.

## Sipas informacioneve që ju keni, cilat janë detyrat kryesore të forumit të grave në partinë tuaj?


Kësaj çështje gratë iu përgjigjën thujse me përpikëmeri duke treguar se e kishin shumë të qartë rolin dhe kompetencat e forumit të grave.



Grafiku 11 – Cilat janë detyrat kryesore të forumit të grave në partinë e tyre sipas informacioneve të tyre

Gratë dhe vajzat e pyetura gjatë sondazhit deklarojnë se forumet janë shumë të rëndësishme dhe kanë patur një impakt si në hyrjen e tyre në parti, ashtu edhe në zhvillimin e karrierës së tyre politike. Efektiviteti i forumit të grave në mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në partitë politike u vlerësua pozitivisht nga pjesëmarrëset në studim. Gjetjet tregojnë se 49% e të anketuarave e konsiderojnë forumin e grave si shumë efektiv, ndërsa 36.8% besojnë se ai është mjaftueshëm efektiv. Megjithatë, kishte edhe shqetësime të shprehura nga ato që mendonin se forumit i mungonte efektiviteti. Disa nga mangësitë e identifikuara përfshinin:

- Fuqinë e kufizuar vendimmarrëse të forumit;
- Mungesën e fondeve;
- Hapësirat dhe mbështetjen e pamjaftueshme;



Grafiku 12 – Opinioni i vajzave dhe grave se sa efektiv është forumi i grave në mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në partinë e tyre politike

### Rekomandime nga pjesëmarrëset në anketë:

Për të forcuar forumin e grave brenda partisë, pjesëmarrëset sugjeruan disa masa. Këto rekomandime përfshinin rritjen e transparencës në proceset e vendimmarrjes, sigurimin e mbështetjes më të madhe financiare për forumin e grave dhe aktivitetet e tij duke krijuar një fond të dedikuar, përcaktimin e një strukture të qartë me objektiva dhe detyra specifike dhe ofrimin e informacionit të plotë për anëtarët e forumit për rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Gjithashtu, pjesëmarrëset theksuan rëndësinë e fokusimit të forumit në lobimin për çështjet e grave dhe vajzave, krijimin e një mjedisi stimulues dhe demokratik brenda partisë, vendosjen e standardeve konkrete dhe të qarta për përfaqësimin e grave dhe promovimin e një sistemi bazuar në meritokraci. Ato sugjeruan gjithashtu investimin në promovimin e modeleve pozitive dhe frymëzuese të grave në politikë.

“

*Citim: “Doja të shprehja se është shumë e rëndësishme mbështetja e grave ndaj grave. Forumet e grave duhet të funksionojnë dhe duhet të fuqizohen dhe kjo të ndikojë në fuqizimin e grave në politikë.”*

”

Pyetjes se cilat ishin rekomandimet e tyre për hapa të mëtejshëm për të për të forcuar dhe mbështetur rolin e gruas në partitë politike, si edhe forumet e grave brenda partive, të anketuarat u përgjigjen:



#### **Propozozimi i më shumë grave në pozita të rëndësishme**

Pjesëmarrëset theksuan rëndësinë e propozimit dhe promovimit aktiv të grave për postet kyçe brenda partisë. Duke rritur me vetëdije përfaqësimin e grave në rolet udhëheqëse, partitë mund të rrisin ndikimin dhe fuqinë e tyre vendimmarrëse.

#### **Sfida e mentalitetit seksist**

Ndryshimi i mentalitetit mbizotërues brenda partive politike u theksua si vendimtar. Duke sfiduar dhe transformuar normat dhe qëndrimet tradicionale gjinore, partitë mund të krijojnë një mjedis më gjithëpërfshirës dhe të balancojnë gjinor.

#### **Zgjedhja e më shumë grave në pozita drejtuese**

Të anketuarat theksuan nevojën për të zgjedhur më shumë gra në pozita udhëheqëse brenda partive politike. Duke siguruar që gratë të kenë akses në rolet vendimmarrëse, partitë mund t'i fuqizojnë ato për të formuar politika dhe agjenda.



### **Krijimi i besimit, mbështetjes dhe konkurrencës transparente**

Pjesëmarrëset rekomanduan krijimin e mekanizmave të besimit, mbështetjes dhe konkurrencës demokratike dhe transparente brenda partive. Kjo përfshin vendosjen e standardeve përtej kuotave gjinore, hartimin e bazave të të dhënave të aksesueshme, nxitjen e debateve me cilësi të lartë pavarësisht nga gjinia dhe sfidimin e nocionit se pozicionet drejtuese janë një monopol i burrave.

### **Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes financiare**

Të anketuarat theksuan rëndësinë e ofrimit të trajnimeve dhe mbështetjes financiare të përshtatura posaçërisht për gratë candidate. Këto burime mund t'i ndihmojnë gratë të ndërtojnë aftësitë e tyre, besimin dhe strategjitë e fushatës, duke rritur në fund shanset e tyre për sukses.

### **Mentorim dhe promovim**

Ofrimi i programeve të mentorimit dhe promovimi aktiv i rritjes së grave në pozita drejtuese mund të mbështesë ndjeshëm rolin e tyre brenda partive politike. Mentorimi i marrëdhënieve dhe promovimet e synuara mund të ndihmojnë në kapërcimin e barrierave dhe paragjyqimeve me të cilat mund të përballen gratë.

### **Sigurimi i zgjedhjeve dhe angazhimeve demokratike**

Krijimi i një procesi më demokratik dhe gjithëpërfshirës për zgjedhjet dhe angazhimet brenda partive politike është thelbësor. Gratë duhet të vlerësohen për kontributet e tyre në vend që të trajtohen thjesht si "dekorime" gjatë fushatave, veçanërisht në kontekstet ku mbizotëron një kulturë seksiste.

Sipas sugjerimeve të pjesëmarrëseve, disa struktura, shërbime dhe nisma të reja mund t'i bëjnë partitë politike më të përgjegjshme ndaj nevojave të grave në radhët e tyre:



### **Ndarja e fondeve të mjaftueshme**

Pjesëmarrëset theksuan rëndësinë e të pasurit burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, veçanërisht të fokusuara në programet e trajnimit për gratë. Rritja e financimit mund të fuqizojë degët e partive për të ofruar më shumë mundësi për avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve të grave.

### **Rritja e pjesëmarrjes së grave**

Të anketuarat kërkuan ndërmarrjen e nismave që synojnë rritjen e numrit të grave të përfshira në partitë e tyre politike. Duke punuar në mënyrë aktive për të tërhequr dhe angazhuar më shumë gra, partitë mund të promovojnë diversitetin dhe përfaqësimin gjinor brenda radhëve të tyre.

### **Rritja e efektivitetit**

Efektiviteti i strukturave ekzistuese mund të përmirësohet duke kryer pyetësorë dhe duke organizuar fokus grupe posaçërisht për gratë dhe vajzat brenda partisë. Këto përpjekje do të ndihmonin në vlerësimin e nevojave të tyre, në mbledhjen e të dhënave të vlefshme dhe në përshtatjen e nismave partiake në përputhje me rrethanat.

### **Forcimi i kuotave gjinore dhe demokratizimi i strukturave të grave**

Pjesëmarrëset sugjeruan rritjen e kuotave gjinore për të siguruar një përfaqësim të drejtë të grave brenda partisë. Ato theksuan gjithashtu rëndësinë e demokratizimit të strukturës së pjesëmarrjes së grave, duke iu referuar me gjasë promovimit të fuqisë dhe mundësive të barabarta vendimmarrëse për gratë.

### **Krijimi i një komisioni për dhunën politike me bazë gjinore**

Për të trajtuar dhunën politike me bazë gjinore, pjesëmarrëset propozuan krijimin e një komisioni për disiplinën. Një komision i tillë mund të ndihmojë në sigurimin e llogaridhënies dhe të ofrojë mbështetje për gratë që përballen me dhunë ose diskriminim brenda partisë.

## **5.2 Gjetjet: Komponenti Cilësor – Fokus grup dhe Intervista me Gratë dhe Vajzat Anëtare të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe Partisë së Lirisë.**

### **INTERVISTAT ME GRATË DHE VAJZAT ANËTARE TË PARTISË SOCIALISTE, PARTISË DEMOKRATIKE, PARTISË SË LIRISË.**

Faza e dytë, pas informacioneve bazë të përfituara nga puna kërkimore ka për qëllim hulumtimin mbi eksperiencat e grave dhe vajzave brenda partive politike, nëpërmjet intervistave, zhvillimit të një fokus grupi dhe një sondazhi më të gjerë, në lidhje perceptimet dhe përjetimet e grave dhe vajzave brenda partive politike dhe realizimin praktik të politikave, parashikimeve statutove apo programeve të partive politike.

30 intervista individuale u zhvilluan me gra dhe vajza nga 3 partitë politike pjesë të studimit, për të diskutuar përvoja dhe këndvështrime personale, rekomandime dhe informacione të ndryshme, si dhe elementë të "historive të patreguara". Personat e intervistuar u përzgjodhën në bazë të pozicioneve të tyre, si drejtuese të strukturave të grave, si drejtuese në nivele të larta të partisë, si përfaqësuese në parlament dhe në këshillat bashkiakë.

Një fokus grup me gra dhe vajza nga partitë politike, u zhvillua në kuadër të hulumtimit të mëtejshëm dhe diskutimit në grup të çështjeve dhe eksperiencave të grave brenda partive politike, aksesin e tyre në struktura, në procese vendimmarrëse, aksesin në financat e partive politike, në përpilimin e politikave, adresimin e dhunës me bazë gjinore të grave në partitë politike, etj.

Të dhënat e përfituara nga intervistat dhe diskutimet në fokus grup, ishin në të njëjtën linjë me ato të përfituara në shkallë më të gjerë nga sondazhet më anëtarët e partive politike, të diskutuara më në thellësi për të kuptuar cilat ishin problematikat, por edhe hapat e rekomanduara nga të intervistuarat në lidhje me adresimin e këtyre problematikave.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrëseve në fokus grup dhe intervista të pyetura nëse përfaqësimi i grave në strukturat drejtuese të partive përkatëse është i mjaftueshëm, shprehen se numerikisht mund të jetë i mjaftueshëm pasi janë respektuar kuotat e vendosura brenda partisë, por **fuqia e tyre vendimmarrëse** shpesh mund të mos jetë ajo që duhet.

Një nga shkaqet kryesore të kësaj situate është edhe **meritokracia**, si fakti i përmendur nga pjesa më e madhe prej tyre, që ndonëse forumet e grave janë të pranishme në strukturën e secilës prej partive, ato nuk kanë një mbështetje të drejtpërdrejtë nga partia. Pra, në strukturat e partisë ka gra të cilat kanë fuqi vendimmarrëse individuale (për shkak të pozicionit që mbajnë dhe mënyrës si kanë performuar në terren dhe në parti), por strukturat e grave në vetvete kanë më pak fuqi në vendimmarrje dhe në influencimin e politikave të partive, jo vetëm përsa i përket çështjeve gjinore, por edhe çështjeve të tjera.

Partitë e pyetura, ashtu siç është përmendur edhe në fillim të këtij studimi, por edhe siç ka rezultuar gjatë intervistave, kanë disa specifika të ndryshme përsa i përket organizimit të brendshëm për të garantuar dhe fuqizuar barazinë gjinore.

**Partia Socialiste** i ka dhënë më shumë vëmendje strukturave të organizimit të partisë, duke parashikuar duplikimin e pozicioneve të kryetarëve të partisë në nivel bashkie dhe duke zgjedhur një burrë dhe një grua bashkëkryetar. Nga intervistat rezulton se kjo është një masë që e ka ndihmuar rritjen e barazisë gjinore brenda partisë, por edhe investimi tek forumi i gruas si strukturë është shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet lënë pas.

Për **Partinë Demokratike**, të intervistuarat shprehet se forumi i grave ka një strukturë aktive, por që ka nevojë të përkthehet edhe në më shumë mbështetje nga Partia për të qënë më shumë prezente tek anëtarët, në komunitetet e ndryshme por edhe si pjesë e zhvillimeve politike.

Për **Partinë e Lirisë**, të intervistuarat shprehen se duke qënë një parti më e vogël edhe strukturat drejtuese janë më afër njëra tjetrës dhe gratë brenda partisë, kanë një zë të konsiderueshëm në vendimmarrje. Kjo Parti (më parë e krijuar si Lëvizja Socialiste për Integrim) ishte e para që vendosi në statut 50% të përfaqësimit të dy gjinive në strukturat vendimmarrëse, por sërish është e rëndësishme rritja e mbështetjes nga ana e partisë në mënyrë që forumi i grave si strukturë të jetë sa më aktiv dhe më pranë komunitetit.

Të intervistuarat theksuan nevojën për bashkëpunime me struktura dhe gra edhe jashtë partive politike, duke afruar pranë partisë edhe personalitete nga fusha e akademisë, shoqërisë civile apo përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme për të hapur sa më tej fushën e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacioneve të vlefshme për angazhimin në politikbërje.

Ajo që u theksua e nevojshme në të gjitha partitë, është që strukturat e grave të jenë aktive edhe kur nuk ka fushata zgjedhore, duke patur mundësinë të jenë më aktive në komunitet, por edhe në adresimin dhe monitorimin e ndjeshmërisë gjinore të politikave të partisë, apo në nivel lokal e vendor, nëpërmjet ekspertizës së forumit apo krijimit të komisioneve me ekspertë në fushën përkatëse.

Gjatë diskutimeve dhe intervistave duket qartë një ndarje mes dy kategorive të mendimit përsa i përket aktivizimit të grave brenda partive. Njëra kategori (më e vogël në numër se tjetra) mendon se gratë kanë mjaftueshëm hapësira brenda partive politike dhe duhet të vetëaktivizohen, duke pranuar në çdo rast se shpesh disa prej barrierave (si aksesit në financat politike, apo dhuna ndaj grave në politikë, etj) nuk kanë mekanizma adresimi brenda partive. Pjesa tjetër, mendojnë se është partia politike e cila duhet të ofrojë kushte mobilizimi, aksesit dhe mekanizma mbështetës për gratë dhe vajzat në mënyrë që të rritet edhe angazhimi, por edhe efektiviteti i kontributit të tyre brenda partisë politike.

Ashtu siç është përmendur edhe gjatë punës kërkimore të statuteve dhe rregulloreve të partive politike, edhe gjatë intervistave dhe diskutimeve rezulton se pjesa më e madhe prej tyre janë relativisht të informuara mbi qëndrimet apo dokumentat zyrtare që ka partia e tyre mbi barazinë gjinore. Nga ana tjetër në perceptimin e tyre, partitë politike, në shembullin edhe të partive të tjera si motra në vende të ndryshme të botës, mund të përmirësojnë disa nga rregulloret, qëndrimet apo politikat në lidhje me barazinë gjinore, për të kaluar përtej niveleve formale të garantimit të barazisë gjinore.

Më specifikisht, të pyetura së cilat janë disa nga çështjet kryesore brenda partive të cilat mund të adresohen për të mos qënë më barriera më të cilat përballen vajzat dhe gratë në partitë përkatëse, pjesëmarrëset dhanë disa mendime:

## 1. Meritokracia dhe demokracia e brendshme e partive

Përfshirë në këtë pohim mënyra se si përcaktohen kandidatët, por edhe pozicionet drejtuese brenda dhe jashtë partive.

Pjesëmarrëset në fokus grup dhe gratë e intervistuarat ranë dakort se meritokracia dhe mekanizmat e përzgjedhjes së kandidatëve dhe drejtuesve në pozicione të ndryshme brenda dhe jashtë partisë, janë një nga elementët kryesorë për të fuqizuar njerëzit e duhur brenda partisë dhe për t'i dhënë shtysë efektivitetit të të gjitha strukturave. Sipas tyre, një nga zgjidhjet kryesore për këtë fenomen, janë edhe hapja e garës dhe ndryshimi i sistemit të përzgjedhjes, qoftë me zgjedhje brenda partisë, qoftë me një sistem zgjedhor si ai me lista të hapura (kur bëhet fjalë për zgjedhje parlamentare ose vendore) që u jep të drejtë të gjithë kandidatëve të kenë shanse për t'u votuar në terren, ndryshe nga ai me lista të mbyllura ku është partia që paracakton në një farë mënyre fituesit/ fitueset.

Një prej shqetësimeve të ngritura më shpesh është edhe mungesa e transparencës në proceset e përzgjedhjes së kandidatëve dhe drejtuesve në pozicione të ndryshme, për këtë sugjerohet që të merren masa, nëpërmjet transparencës së proceseve të rekrutimit, përzgjedhjes dhe emërimit, si edhe nëpërmjet promovimit periodik të grave dhe kontributeve përkatëse brenda partive politike.

Disa nga citimet e të intervistuarave janë si në vijim:

“Mendoj se transparencja është problem kryesor në partinë tonë, pasi edhe përzgjedhja e grave kandidatë nuk është transparente. Shpesh përzgjidhen njerëz që sapo kanë hyrë në parti, nuk kanë dhënë asnjë kontribut në parti, por që thjesht i shohim nëpër listat e kandidatëve ose në pozicione drejtuese.”

“Do të sugjeroja që të promovohen sa më shumë shembuj pozitivë të grave e vajzave në karrierë por që gjithashtu kanë një ecuri dhe angazhim politike në kohë. Brenda Partisë është shumë i rëndësishëm zbatimi i parimit të meritokracisë dhe mbështetja e figurave profesionale.”

“Transparenca në alokimin e fondeve financiare si edhe tranparenca në përzgjedhjen e kandidatëve është me rëndësi, pasi ose forcon ose humbet besimin te partia!”

## 2. Aksesi në financat politike dhe transparencja

Një nga problematikat kryesore që gratë dhe vajzat ngrenë është aksesi në financa, si në pozicionin e kandidatëve, si përsa u përket strukturave të grave brenda partive politike. Mungesa e aksesit në financa dhe e mbështetjes financiare nga partitë politike të forumeve të grave është një nga shkaqet për mungesën e aktivitetit efektiv të forumeve të grave, investimit tek rritja e numrit të grave dhe kontributit përkatës brenda partive politike.

Aksesi në financa duket se është problematika kryesore edhe për forumet, edhe për gratë kandidatë, të cilat gjenden në situata të pabarazisë për të garuar në zgjedhje.

Disa nga citimet e të intervistuarave janë si në vijim:

“Mendoj se problematika kryesore për forumin dhe strukturat e grave brenda partive, është mungesa e burimeve financiare për organizimin e eventeve, organizime jo vetëm gjatë fushatave, por trajnime dhe bisedime më të shpeshta.”

“Kuotat mund të vendosen dhe mund të zbatohen, por nëse hyjmë në lista dhe s’kemi asnjë mbështetje, atëherë bëhet kriter përzgjedhje pasuria individuale, kjo e shkatërron meritokracinë që është aq e nevojshme.”

“Gratë kandidatë kanë dhe shpenzime shtesë që s’i merr parasysh asnjë njeri. Duhet të mbulojnë shpenzimet e shtepisë dhe kujdesit të fëmijëve gjatë kohës së fushatës në krahasim me një burrë që nuk i ka këto shpenzime.”

### 3. Dhuna ndaj grave në politikë

Kur flasim për dhunën me bazë gjinore mendojmë menjëherë shtresat e marginalizuara, apo dhunën brenda familjes. Në fakt është një prej fenomeneve kryesore që kthehet në barrierë për angazhimin e vajzave dhe grave në politikë. Ndërkohë që kuotat dhe aktivitetet e përbashkëta kanë ndihmuar në ngushtimin e hendekut gjinor politik, partitë politike nuk adresojnë dhunën ndaj grave brenda partive të tyre dhe sistemit politik në përgjithësi. Pjesërisht, ky dështim buron nga mungesa e të kuptuarit të asaj se çfarë përbën dhunë. Edhe shumë gra politikisht aktive e konsiderojnë bullizmin, ngacmimin dhe shpifjen si çmimin e natyrës “së vrazhdë” të politikës, pa e njohur realisht si dhunë me bazë gjinore, për shkak të angazhimit politik.

Përtej rasteve dhe eksperiencave të ndryshme të dhunës, një gjë është e përbashkët. Janë të rralla reagimet nga partia apo kolegët për ta kundërshtuar atëherë kur ndodh, ndoshta duke e konsideruar një fenomen normal dhe të pandreqshëm brenda politikës.

Sipas të intervistuarave, manifestimet e ndryshme të dhunës gjatë angazhimit politik, ndahen në tre kategori:

#### Dhuna psikologjike

*“Kam pësuar kërcënime të ndryshme për çështje që kam ngritur në Këshillin Bashkiak”*

*“Jam detyruar me kërcënim nga partia të votoja për një vendim që nuk më dukej i drejtë dhe që binte ndesh me interesat e qytetarëve!”*

*“Kjo nuk më ka ndodhur mua, por di disa raste të kolegeve të cilat janë detyruar të dorëhiqen nga listat e kandidatëve, për t’u lënë vendin burrave! Kjo nuk është e drejtë!”*

#### Dhuna verbale

*“Ne parlament u etiketova me disa fjali fyese nga njëri prej deputetëve burra. Seksizmi ishte i qartë dhe gjuha ishte shumë fyese! Kolegët e partisë sime nuk reaguan...”*

*“Kohët e fundit, fotografitë e mia private u manipuluan dhe u shpërndanë në rrjetet sociale pa pëlqimin tim, me tekste seksiste dhe fyese! Partia dhe kolegët nuk patën asnjë reagim.”*

*“Fyerjet dhe gjuha e urrejtjes në komentet e një artikulli të publikuar për mua, ishin të padurueshme. Sharje dhe fyerje, sidomos për shkak të gjinisë pa asnjë argument mbi atë që përmendte artikulli. Nuk e di a do zgjidhja më të kisha një zë të fortë në shoqëri, nëse do i kisha ditur të gjitha sulmet që do të pësoja. Ka njerëz që heshtin dhe nuk i sulmon njeri!”*

## Dhuna fizike

*“Po, kam patur kërcënime fizike, gjatë procesit të numërimit të votave në Njësinë time. Nuk isha kandidate por isha pjesë e komisionit.”*

*“Në vitet e para të demokracisë, makina ime si kandidate është qëlluar me armë, isha brenda bashkë me bashkëshortin tim! Nuk u tërhoqa, e vazhdova fushatën dhe fitova, por ka qënë një nga përjetimet më të këqija në jetën time! Politika sot ka ndryshuar disi, por dhuna ka marrë forma të tjera që janë pengesa për gratë!”*

## 4. Organizimi dhe funksionimi i forumeve dhe strukturave të grave brenda partive politike

Disa nga problematikat kryesore që ngrihen në lidhje me forumet e grave brenda partive kanë lidhje me mbështetjen dhe qëndrueshmërinë financiare të forumeve. Sipas pohimeve të të intervistuarave, shpesh forumet nuk kanë financat as për të mbajtur një staf të qëndrueshëm dhe as për të organizuar aktivitete. Edhe kostot e transportit dhe kosto të ndryshme të cilat mund të ndodhin gjatë veprimtarisë, janë të pambuluara, ndaj angazhimi në to është më së shumti vullnetar. Kjo është diçka pozitive për përkushtimin e anëtarëve, por sjell paqëndrueshmëri përsa i përket strukturës. Gjatë kohës së fushatave zgjedhore partia mbulon disa nga shpenzimet për veprimtaritë e ndryshme, por edhe në ato periudha mbështetja nuk është e mjaftueshme. Nga ana tjetër një nga problematikat që ngrihen janë edhe përsa i përket funksionimit të forumeve, meritokracisë dhe transparencës, të cilat, sipas pjesës më të madhe të të intervistuarave nuk janë ende në nivelet e duhura.

Disa citime nga të intervistuarat si në vijim:

“

*“Është e rëndësishme vendosja e kriterëve të sakta që lidhen me meritokracinë dhe promovimin brenda strukturave të partisë dhe të forumit. Vendosja e parimit - 1 anëtar 1 votë - në zbatim për çdo shkallë organizimi të forumit, do të ishte shumë efektive”.*

*“Mendoj që struktura më e rëndësishme e Partisë, është Forumi i Gruas, sugjerimi im do të ishin mbledhjet më të shpeshta duke përfshirë diskutime të problematikave të përditshme të grave, por pse jo edhe shkëmbime socializuese mes njëra-tjetrës!”*

*“Do ta shtonte efektivitetin e Forumit edhe shtim i përfaqësuesve të grave dhe vajzave të cilat nuk janë të angazhuara me politike, duke organizuar qoftë edhe takime me to dhe duke ftuar sa më shumë gra nga shoqëria civile, nga biznesi dhe fusha të tjera që duan të fuqizojnë rolin e gruas në shoqëri.”*

*“Më shumë aktivitete sociale të zhvilluara nga Forumet do t'i çonin ato më pranë komuniteteve”.*

*“Forumet duhet të kenë staf të kualifikuar, nuk mund të mbështeten vetëm tek kontributet vullnetare të anëtarëve.”*

”

## 5. Mungesa e programeve të qëndrueshme për rritjen e kapaciteteve

Një prej kërkesave kryesore të vajzave dhe grave, në pjesën më të madhe të anketimeve që kryhen për vlerësimin e nevojave, por edhe në këtë anketim, ka lidhje me rritjen e kapaciteteve. Aktualisht asnjëra prej partive nuk ka një program të qëndrueshëm për rritjen e kapaciteteve dhe kjo është një nga kërkesat kryesore që vjen nga gratë dhe vajzat pjesë e partive. Gratë përmendin në intervista dhe në fokus grup se kanë qënë pjesë e disa trajnimeve të organizuara nga organizata ndërkombëtare dhe lokale (si OSBE, NDI, WFD, UN, RSI, Rrjeti "Barazi në Vendimarrje", Akademia e Studimeve Politike, etj) por jo në trajnime specifike të organizuara nga vetë partitë dhe forumet e grave përkatëse.

Disa nga citimet për këtë çështje:

“

*“Duhet shumë punë dhe nisma konkrete për mbështetjen e grave, sidomos ato financiare, por edhe të trajnohen vazhdimisht me organizatat trajnuese për të qenë të afëta në përfaqësimin e tyre si në pushtetin vendor dhe atë qendror.”*

*“Trajnime duhet të ketë më shumë, si dhe mbështetje financiare dhe profesionale brenda partisë.”*

*“Efektivitetin e të gjithë punës për gratë do ta rrisnin më shumë takime me gratë në komunitet, tryeza kundër dhunës ndaj grave, mbështetje të grave kandidate përmes trajnimeve. Të promovohen në media dhe rrjete sociale gratë, të kualifikohen në trajnime për komunikimin publik dhe aftësimin në bërjen e fushatës.”*

*“Trajnime në të gjitha Njësitë Administrative, si edhe biseda me gratë kryefamiljare për të dëgjuar zërin e tyre për problemet që i shqetësojnë.”*

”

## 6. Mentaliteti

Kultura patriakale dhe seksizmi janë gjithashtu problematika që u ngritën nga gratë dhe vajzat e intervistuar, në vijim disa nga citimet:

“

*“Një nga problemikat kryesore tek gratë dhe vajzat është mungesa e mundësive që ato të dalin apo të shfaqen që merren me angazhim politik, duke patur parasysh edhe tabutë e vjetra dhe paragjykimet që ato marrin nga komuniteti i tyre”*

*“Mendoj se mentaliteti i ngurosur, demokracia e brendshme, procesi i rekrutimit janë disa nga pengesat e hasura me të cilat përballen gratë dhe vajzat”.*

*“Më është bërë presion që të tërhiqem nga posti im për t'u zëvendësuar nga një burrë pas publikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale! Nuk e bëra por presioni ishte shumë i madh!”*

”



## 6. Konkluzione

Në përfundim të këtij studimi, mund të theksohet se në Shqipëri janë hedhur hapa të rëndësishëm përpara i përket barazisë gjinore në politikë dhe në vendimmarrje, që nga legjislacioni e deri tek pasqyrimi në statutet e partive politike.

Parimi i barazisë gjinore përmendet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Nenin 18, pika 2), ku në bazë të parimit të mosdiskriminimit theksohet se: "Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore."

Në vijim, hapa të rëndësishëm janë hedhur për arritjen e barazisë gjinore në sajë të miratimit të kuadrit ligjor dhe përforcimit të masave ndëshkuese për mosrespektimin e tij. Në një përmbledhje të legjislacionit kryesor për barazinë gjinore mund të përmenden:

### Legjislacioni

- Ligji kryesor nëpërmjet së cilit garantohet barazia gjinore është **Ligji nr. 9970/2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"**<sup>51</sup>, i cili fuqizon masat për mbrojtjen e qytetarëve nga çdo lloj diskriminimi që kryhet për shkak të gjinisë, si dhe garanton krijimin e mundësive të barabarta si për burrat edhe për gratë, për të arritur standarte sa më të larta në fushën e barazisë gjinore.
- Barazia gjinore dhe pjesëmarrja e barabartë në vendimmarrje parashikohen në **Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"**<sup>52</sup> i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Ky ligj parashikon që qasja gjinore të jetë e integruar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, që nga hartimi i politikave dhe buxheteve vendore e deri tek zbatimi dhe vlerësimi i performancës.
- Në vijim të garantimit të pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në proceset vendimmarrëse, **Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë**<sup>53</sup> (**Ligji Nr. 10 019/2008**) parashikon kuotën gjinore dhe disa mekanizma plotësues dhe sanksionues, si instrumente për të promovuar dhe arritur barazinë gjinore. Kodi Zgjedhor parashikon që në listat shumëemërore të kandidatëve për Këshillat Bashkiakë duhet të zbatohet kuota gjinore prej 50% në secilën zonë zgjedhore, si dhe kuota 30% në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë.
- Kuadri ligjor është përmirësuar edhe më tej me miratimin e **Ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"**<sup>54</sup> që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, etj. Në këtë linjë, **Ligji nr.9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"**<sup>55</sup> synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në të gjitha format e saj.

<sup>51</sup>Ligji Nr.9970/2008 [http://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia\\_gjinore\\_shoqeri.pdf](http://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf)

<sup>52</sup>Ligji Nr. 139/2015 <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore?fbclid=IwAR0PdS2KXbbYiezeTYk5ifPtxX8eOqkNcNtLois2hEBqC56ty5o9GXKksë>

<sup>53</sup>Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë <https://www.parlament.al/Informacion/AkteNormative/13>

<sup>54</sup>Ligji 10221/2010 <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1308053956-Ligji-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi.pdf>

<sup>55</sup>Ligji Nr. 9669/2006 <http://www.parlament.al/Files/Akte/ligj%20nr.%2047,%20dt.%2023.7.2018.pdf>

Megjithëse janë bërë hapa të rëndësishëm përpara i përket edhe legjislacionit, edhe numrit të grave të përfaqësuar në pozicione drejtuese në nivel qendror dhe lokal, gratë në politikë dhe në vendimmarrje ende hasin rezistencë në rrugën e tyre për të thyer "tavanin e qelqtë". Kjo ndodh si rezultat i një klime të pabarazive gjinore që fshihet pas hapave formalë drejt barazisë, pasi në realitet ka ende pengesa të shumta si, rolet dhe stereotipet sociale e kulturore, mungesa e informacionit dhe vizibilitetit për rolin dhe aftësitë e tyre, besimi i ulët, aksesit në financat politike, dhuna me bazë gjinore për shkak të angazhimit politik, etj.

Mbështetja e grave në partitë politike nuk shërben vetëm për forcimin e zërit të tyre dhe mundësisë për t'u shërbyer nevojave të komunitetit si politikane, por edhe për të krijuar një model aktiv të angazhimit publik të vajzave dhe grave, drejt niveleve më të larta të përfaqësimit, jo vetëm në politikë. Në këtë këndvështrim, krijimi i modeleve të grave aktive dhe në role udhëheqëse në politikë, është një përparësi që partitë mund të krijojnë edhe për elektoratin e tyre. Angazhimi dhe promovimi i grave brenda partive politike sjell përfitime të panumërta edhe për vetë partitë, që nga zgjerimi i mbështetjes nga anëtarësia e deri tek ekspertiza dhe perspektiva gjinore e politikave të ndërmarra, që shkojnë shumë më afër me nevojat e komuniteteve.

Partitë e pyetura, ashtu siç është përmendur edhe në fillim të këtij studimi, por edhe siç ka rezultuar gjatë intervistave, kanë disa specifika të ndryshme përpara i përket organizimit të brendshëm për të garantuar dhe fuqizuar barazinë gjinore.

Partia Socialiste i ka dhënë më shumë vëmendje strukturave të organizimit të partisë, duke parashikuar duplikimin e pozicioneve të kryetarëve të partisë në nivel bashkie dhe duke zgjedhur një burrë dhe një grua bashkryetarë. Nga intervistat rezulton se kjo është një masë që e ka ndihmuar rritjen e barazisë gjinore brenda partisë, por sipas grave dhe vajzave të intervistuar, edhe investimi tek forumi i gruas si strukturë është shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet lënë pas. Në rang përfaqësimi, brenda strukturave të ndryshme të partisë, ka zbatuar kuotën 40%-50%.

Partia Demokratike, sipas hulumtimit dhe përgjigjeve të të intervistuarave duket se ka një forum të grave me një strukturë aktive, por që në dokumenta dhe nga intervistat rezulton se, ka nevojë për më shumë mbështetje nga Partia (askes në burime dhe financa) për të qënë më shumë prezente tek anëtarët, në komunitetet e ndryshme, por edhe si pjesë e zhvillimeve politike. Ndërkohë në rang përfaqësimi në strukturat brenda partisë, Partia Demokratike ka zbatuar kuotën 30%.

Partia e Lirisë, rezulton nga hulumtimi dhe intervistat, se duke qënë një parti më e vogël edhe strukturat drejtuese janë më afër njëra-tjetrës. Duket se gratë brenda partisë kanë një zë të konsiderueshëm në vendimmarrje dhe kjo Parti (më parë e krijuar si Lëvizja Socialiste për Integrim) ishte e para që vendosi në statut 50% të përfaqësimit të dy gjinive në strukturat vendimmarrëse dhe ndarjen e buxhetit për forumet e grave dhe të të rinjve, por sërish është e rëndësishme rritja e mbështetjes nga ana e partisë në mënyrë që forumi i grave si strukturë të jetë sa më aktive dhe më pranë komunitetit. Nga hulumtimi, rezulton se Partitë nuk kanë programe apo strategji publike për barazinë gjinore dhe një nga vështirësitë e hasura gjatë studimit është vështirësia në aksesin e dokumentave mbështetëse përtej statuteve.

Nga intervistat dhe përvoja politike, vërehet se me gjithë përmirësimet dhe ndryshimet e fundit statutores, duhet ende të punohet për forcimin e kohezionit brenda partisë, rritjen e transparencës dhe përcaktimin e qartë të kriterëve të meritokracisë dhe të përmirësimit të sistemit të të bërit karrierë, brenda strukturës së partisë. Sipas të intervistuarave në kuadër të këtij studimi, përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit, mes strukturave të partisë dhe forumit të gruas, është domosdoshmëri.

Përfaqësimi i grave në të gjitha nivelet e përfaqësimit politik, është i mirë dhe kjo ka ndikuar edhe në përfaqësimin më të lartë në vendimarrje. Pra caktimi në statut i kuotave, ka nxitur rritjen e përfaqësimit të grave, por në bazë të intervistave, ka ende vend për përmirësim në kuadër të meritokracisë, demokracisë së brendshme dhe respektimit të përvojave dhe eksperiencës së grave që kanë një periudhë të gjatë në parti dhe në forume.

Në këtë kuptim, nga puna kërkimore rezulton qartë se partitë politike i kanë përfshirë parimet dhe mekanizmat për barazi gjinore në dokumentat bazë të tyre, por mbeten mbrapa në adresimin e disa barrierave që janë kyçe për zhvillimin dhe fuqizimin real të grave dhe vajzave brenda partive. Disa nga problematikat dhe barrierat kryesore të theksuara nga gratë dhe vajzat në kuadër të këtij studimi, kanë lidhje me mungesën e meritokracisë, mungesën e aksesit në financa, mungesën e mbështetjes nga partia, seksizmin dhe dhunën me bazë gjinore, etj.

Duke qënë se partitë politike kanë një rol kyç në politikbërje, është shumë e rëndësishme që të japin të parat modelin e shanseve të barabarta përtej gjinisë dhe mbështetjes së meritokracisë në funksionimin e tyre, për ta përthyer më tej edhe në alternativa më të gjera qeverisëse.

Këto gjetje nënvizojnë sfidat e vazhdueshme dhe nevojën për masa proaktive për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për të promovuar diversitet më të madh gjinor brenda strukturave të partive politike, ndaj është e rëndësishme marrja parasysh e rekomandimeve në vijim.

## 7. Rekomandime

Në vijim të rekomandimeve të parashtruara nga vajzat dhe gratë pjesë intervistave, sondazheve dhe takimeve në kuadër të këtij studimi, disa rekomandime për partitë politike që do të ishin hapa të rëndësishëm për fuqizimin real të forumeve dhe të grave brenda partive, janë:

### PËR PARTITË POLITIKE:

**1.** Krijimi i programeve për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave brënda partisë politike. Një qasje e kombinuar e ndërhyrjeve është e nevojshme përmes: rrjetëzimit, ngritjes së kapaciteteve dhe përforcimit të fuqisë së grave në vendimmarrje brenda partisë, si dhe mbështetja e grave ligjvënëse me ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve dhe mentorimi i qëndrueshëm për zhvillimin e tyre brenda partive politike, në veçanti gjatë fushatave zgjedhore. Nga eksperiencia e Partive të tjera në vende të ndryshme të botës, këto janë programe të qëndrueshme periodike brenda partive politike, ose në bashkëpunim me organizata të atashuara pranë tyre.

**2.** Krijimi i mekanizmave për të garantuar meritokracinë dhe demokracinë e brendshme të partive politike, si në zgjedhjet brenda strukturave (për shembull me parimin një anëtar një votë) ashtu edhe me garantimin e transparencës përsa i përket mënyrës se si përcaktohen kandidatët, por edhe pozicionet drejtuese brenda dhe jashtë partive.

Meritokracia dhe mekanizmat e përzgjedhjes së kandidatëve dhe drejtuesve në pozicione të ndryshme brenda dhe jashtë partisë, janë një nga elementët kryesorë për të fuqizuar njerëzit e duhur brenda partisë dhe për t'i dhënë shtysë efektivitetit të të gjitha strukturave. Nga eksperiencia e partive në vende të ndryshme të botës, një nga mënyrat se si mund të përforcohet sistemi i meritokracisë, janë votimet paraprake në struktura për kandidime për pozicione të ndryshme vendimmarrëse, si primaret, apo propozimet brenda strukturave. Nga ana tjetër llojet e sisteme zgjedhore që favorizojnë më shumë meritokracisë, janë sistemet zgjedhore me votim mazhoritar ose me lista të hapura, në mënyrë që kandidatët që arrijnë të marrin më shumë vota, të jenë ata që përzgjidhen në postet e caktuara (deputetë, këshilltarë bashkiakë, etj).

**3.** Përmirësimi i aksesit të grave në burime dhe financime. Realizimi i mekanizmave të ndryshëm për të siguruar që kandidatët gra dhe burra të kenë akses të barabartë si në financimin politik, ashtu edhe në mundësitë për mbledhjen e fondeve, si për shembull kuotat për financimin publik. Krijimi i mekanizmave të mbështetjes financiare për t'u mundësuar kandidatëve pjesëmarrjen e plotë në fushatën zgjedhore: duke u mbuluar kostot operacionale; duke u krijuar mbështetje për kujdesin ndaj fëmijëve, etj.

Duke qënë se aktualisht forumet e grave në partitë politike kanë pothuajse zero akses në financat e partisë, kjo mund të arrihet në disa mënyra, dy prej të cilat mund të jenë:

- a. Vendosja me ligj i një përqindje nga financat që partia përfiton nga buxheti i shtetit, e cila i kalon drejtpërdrejtë forumit të gruas apo strukturave të grave brenda partisë.
- b. Vendosja në statutin e partisë politike të një kuote të përcaktuar që strukturat e grave apo gratë candidate mund të përfitojnë në mënyrë periodike nga totali i financave të partive.

**4.** Forcimi i bashkëpunimit me OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare dhe vendore në punën kërkimore, realizimin e politikave dhe rritjen e kapaciteteve.

**5.** Rritja e transparencës dhe komunikimit brenda partisë, për të arritur një angazhim më të mirë dhe më efektiv të grave në proceset vendimmarrëse dhe në aktivitetet e partive politike përmes:

- ✓ promovimit të pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve të partisë në çështjet e brendshme të saj,
- ✓ krijimit të mundësive që anëtarët të shprehin pakënaqësitë e tyre, në kuadër të partisë,
- ✓ përmirësimit të komunikimit brenda partisë dhe transparencën e mundësive të karrierës.

Një nga eksperiencat kryesore në lidhje me transparencën që vjen nga partitë e ndryshme në nivel botëror, është publikimi dhe ndarja me anëtarët e partisë dhe me publikun, të raporteve financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe monitorimi apo auditimi i fondeve që shpenzohen periodikisht dhe gjatë fushatave elektorale.

**6.** Krijimi i protokolleve dhe mekanizmave për të adresuar dhunën me bazë gjinore brenda partive politike përmes:

- ✓ krijimit të kodit të etikës brenda partisë politike;
- ✓ krijimit të protokolleve për denoncimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore për shkak të angazhimit në politikë.

**7.** Kryerja në mënyrë periodike e një "auditimi gjinor" brenda partisë politike, për të përcaktuar përmbushjen e të gjithë elementëve të nevojshëm për garantimin e barazisë gjinore, buxhetimit gjinor, politikave të ndjeshme gjinore brenda partisë, etj.

**8.** Implementimi i buxhetimit gjinor brenda partisë politike.

## PËR INSTITUCIONET LEGJISLATIVE DHE EKZEKUTIVE

1. Rishikimi dhe integrimi i elementëve të ndjeshëm gjinorë në ligjin për partitë politike në Shqipëri.
2. Rishikimi i legjislacionit të financimit të partive politike për të vendosur mekanizmat e financimit gjinor.
3. Rishikimi i kodeve institucionale të etikës dhe ndërmarrja e protokolleve për të adresuar dhunën me bazë gjinore në politikë dhe në vendimmarrje.

## PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE & ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

1. Krijimi i mundësive të mbështetjes së forumeve të grave brenda partive politike, por edhe i grave kandidate dhe në pozicione vendimmarrëse, nëpërmjet programeve të rritjes së kapaciteteve, mbështetjes teknike dhe fuqizimit.
2. Rritja e mundësisë së bashkëpunimeve mes grave dhe vajzave të partive të ndryshme politike, për të ndarë eksperiencat, praktikat më të mira, por edhe për të advokuar në lidhje çështje të përbashkëta.
3. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i zbatimit të barazisë gjinore brenda partive politike.
4. Angazhimi aktiv përsa i përket ndërgjegjësimit dhe adresimit të dhunës me bazë gjinore të vajzave dhe grave në politikë.
5. Advokim dhe lobim për përmirësimin dhe realizimin e një legjislacioni të ndjeshëm gjinor për funksionimin dhe financimin e partive politike.

## 8. Bibliografia & Referenca

- Edlira Cepani & Raquel H. Pena. National Democratic Institute- Gjinia, Paratë dhe Politika, 2017 [http://www.platformmagjinore.al/publikime/#EDM\\_publikime](http://www.platformmagjinore.al/publikime/#EDM_publikime)
- Eden B. King., Mikki Hebl., Jennifer M. George., Sharon F. Matusik (2010) Understanding Tokenism: Antecedents and Consequences of a Psychological Climate of Gender Inequity [https://www.researchgate.net/publication/247570267\\_Understanding\\_Tokenism\\_Antecedents\\_and\\_Consequences\\_of\\_a\\_Psychological\\_Climate\\_of\\_Gender\\_Inequity](https://www.researchgate.net/publication/247570267_Understanding_Tokenism_Antecedents_and_Consequences_of_a_Psychological_Climate_of_Gender_Inequity)
- Sarah Glatte & Catherine E. de Vries. Gender Norms and Gender Gaps in Political Participation in Unified Germany. [http://catherinedevries.eu/Glatte\\_DeVries\\_Feb2015.pdf](http://catherinedevries.eu/Glatte_DeVries_Feb2015.pdf)
- Edlira Cepani & Raquel H. Pena. Westminster Foundation for Democracy - Gjinia, përfaqësimi dhe partitë e Djathta 2022 [http://www.platformmagjinore.al/publikime/#EDM\\_publikime](http://www.platformmagjinore.al/publikime/#EDM_publikime)
- Rumbidzai Kandawasvika-Nhundu The role of political parties on womens participation and representation. <https://www.idea.int/sites/default/files/publications/the-role-of-political-parties-on-womens-participation-and-representaion-en.pdf>
- Asiyati Lorraine Chiweza (2016) Women in Local Government. A Potential Arena for Women's Substantive Representation. <https://www.cmi.no/publications/5930-women-in-local-government-potential-malawi>
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 2017.
- Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Pjesa III, Neni 15, faqe 6. <https://www.mod.gov.al>
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin nr. 101/2020, date 23.07.2020 <https://qbz.gov.al>
- Ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1308053956-Ligji-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi.pdf>
- Ligj Nr. 9699/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" <http://www.parlament.al/Files/Akte/ligj%20nr.%2047,%20dt.%2023.7.2018.pdf>
- [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020\\_1.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Ligji-per-partite-politike-2020_1.pdf)
- Statuti i Partisë Socialiste
- Statuti i Partisë Demokratike 18.12.2021 <https://pd.al> – drejtuar nga Z. Lulzim Basha
- Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë 11.12.2021 <https://pdsh.al> Drejtuar nga Z. Sali Berisha
- Statuti i Partisë së Lirisë <https://partiaelirise.al/sta/>
- Ligji Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore në Republikën e Shqipërisë" <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-ve-teqeverisjen-vendore?fbclid=IwAR0PdS2KXbbYiexzeTYk5ifPtxX8eOqkNcNtLois2hWBqC56ty5o9GXXksë>

## 9. Aneks - Pyetësor

Barometri i Barazisë Gjinore në Partitë Politike në Shqipëri

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të studimit "Barometri i Barazisë Gjinore në Partitë Politike në Shqipëri" që zhvillohet nga Rrjeti "Barazi në Vendimmarrje" me mbështetjen e Westminster Foundation for Democracy (WFD) në Shqipëri dhe Ambasadës Britanike në Tiranë, në kuadër të zbatimit të nismës "Forcimi i integritetit zgjedhor dhe qëndrueshmërisë së partive politike", e cila ka në fokus forcimin e demokracisë dhe mbështetjen e partive politike në Shqipëri dhe rritjen e integritetin në politikë.

Ky studim ka për qëllim hulumtimin mbi pozicionin dhe problematikat që kanë gratë dhe vajzat brenda partive politike në Shqipëri dhe në disa vende të ndryshme të botës, si dhe garantimin e mëtejshëm të barazisë gjinore në partitë politike dhe fuqizimin e strukturave të tyre.

**Të dhënat personale të personave që do të plotësojnë studimin janë konfidenciale dhe NUK DO TË PUBLIKOHEN. Informacionet e përfituara nga ky pyetësor do të përdoren vetëm për efekt të studimit.**

Ju falenderojmë paraprakisht për kohën tuaj!

### TË DHËNAT PERSONALE:

Emri & Mbiemri\*

Kontakt (Adresa E-mail)\*

Kontakt (Nr. Telefoni)

Mosha\*

- <20 vjeç
- 20-30 vjeç
- 30-40 vjeç
- 40-50 vjeç
- 50-60 vjeç
- >60 vjeç

Statusi civil

- E martuar
- Beqare
- Tjetër
- Other:



Arsimi\*

- Diplomë e Shkollës së Mesme
- Diplomë Universitare
- Diplomë e Studimeve pas universitare (Master, Speciallizim, etj)
- Doktoraturë (PhD)
- Other:

Profesioni\*

A e ushtroni profesionin tuaj gjatë kohës së përfshirjes në fushën e politikës?\*

- Po, e ushtroj
- Jo, nuk e ushtroj

ANGAZHIMI NË POLITIKË

Cilës parti politike i përkisni?\*

- Partia Socialiste e Shqipërisë
- Partia Demokratike e Shqipërisë
- Partia e Lirisë

Cili ishte kanali kryesor i hyrjes suaj në parti? \*

(Mund të zgjidhni më shumë se 1 opsion)

- Pjesëmarrja ime në aktivitetet e Partisë Politike
- E ftuar nga partia politike për t'u angazhuar
- Përfshirja në forumet e partisë (forumi rinor, forumi i grave, etj).
- Lidhjet familjare dhe tradita
- Pjesëmarrja në trajnime/akademi për candidate potenciale të organizuara nga organizata jo-qeveritare (Ju lutem specifikojeni)
- Tjetër (ju lutem specifikoni)
- Other:

A jeni zgjedhur ndonjëherë në ndonjë nga pozicionet e mëposhtme?

- Anëtare e Parlamentit
- Kryetare Bashkie
- Anëtare e Këshillit Bashkiak
- Ministre
- Nuk jam zgjedhur ne asnjërin prej pozicioneve të mësipërme
- Tjetër (Ju lutem specifikojeni):
- Other:

Nëse po, sa herë keni kandiduar ose jeni zgjedhur në pozicionet e mësipërme (ju lutem specifikoni)?

Nëse po, si keni arritur të bëheni kandidate për pozicionet publike të zgjedhura (deputete, anetare e keshillit bashkiak, kryetare bashkie?

- Jam propozuar dhe përzgjedhur nëpërmjet një proçesi brenda partisë
- Jam përzgjedhur dhe nominuar nga forumi i grave / forumi rinor, etj.
- Me ftesë nga Kryetari i Partisë
- Tjetër (ju lutem specifikoni)
- Other:

Nëse po, çfarë zone zgjedhore keni kandiduar?

- Zonë Rurale
- Zonë Urbane (Qytet)
- Kam kandiduar disa herë edhe në zonë rurale edhe në zonë urbane
- Other:

A keni patur ndonjë funksion zyrtar brenda partisë tuaj politike? \*

- Po
- Jo

Nëse po, ju lutem specifikojeni:

#### EKSPERIENCA E GRAVE NË PARTITË POLITIKE:

Cilën konsideroni si problematikën më sfidauese për gratë në politikë?  
(zgjidhni 3 opsionet që janë më problematike për mendimin tuaj) \*

- Mungesën e qëndrueshmërisë dhe ngritjes në karrierë në fushën e politikës
- Proçesin e rekrutimit në parti
- Përzgjedhjen dhe nominimin për kandidate në listat e partisë (për zgjedhje lokale dhe parlamentare)
- Garën / Fushatën zgjedhore
- Të qënurit grua në karrierë politike
- Aksesin në burime dhe financa / Ngritjen e fondeve
- Funksionimin e brendshëm të partisë (demokracia e brendshme, transparenca, etj)
- Presionet dhe dhunën ndaj grave në politikë
- Tjetër (Ju lutem specifikojeni)

Koment - Specifikim për sa më sipër

Sipas mendimit tuaj, sa ndikim kanë treguesit e mëposhtëm në frenimin / pengimin e grave për t'u bërë pjesë e partive politike?

	Shumë Ndikim	Kanë Ndikim	Nuk ka shumë ndikim	Nuk e di
Mungesa e mundësive dhe përkushtimit për identifikimin, trajnimin dhe mentorimin e grave kandidate për poste publike				
Mungesa e mbështetjes nga burrat brenda partisë politike.				
Mungesa e mbështetjes nga gratë brenda partisë politike.				
Mungesa e mbështetjes financiare nga partia politike edhe mungesa e aksesit në burime.				
Mungesa e fuqisë dhe ndikimit të forumit të gruas brenda partisë.				

Kultura seksiste në partitë politike.				
Dhuna fizike ose psikologjike në fushën politike				
Mungesa e demokracisë së brendshme të partisë				
Tjetër (Ju lutem specifikojeni në rreshtin e mëposhtëm)				

Tjetër (Ju lutem specifikojeni)

Ju personalisht, a jeni përballur ndonjëherë me këto vështirësi në partinë tuaj? \*

	Po	Jo	E pasigurtë / Ndoshta
Sjellje / Gjuhë përçmuese ose ngacmuese			
Rregulla dhe normat të pashkruara që ndikojnë negativisht në pjesëmarrje dhe në akses			
Partinë e dominojnë burrat			
Mungesë e burimeve dhe informacionit për të kryer detyrat e mia			
Seksizëm dhe pengesa për shkak të gjinisë			
Mungesë aksesi & mbështetje financiare			
Tjetër (Ju lutem specifikojeni në rreshtin e mëposhtëm)			

Tjetër (Ju lutem specifikojeni)

A ka partia juaj një qëndrim zyrtar, një rregullore apo një politikë të shkruar mbi pikat e mëposhtme?

	Po	Jo	Nuk e di
Vlerat dhe parimet e barazisë gjinore			
Masa të veçanta (kuota ose vende të rezervuara) për të siguruar përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në Komisionet Ekzekutive, Komitetet dhe Komisionet brenda partisë.			
Projekte/Masa të veçanta për rritjen e rekrutimit të grave dhe vajzave në partinë tuaj			
Komisionin për Barazinë Gjinore brenda partisë			
Protokollin për parandalimin dhe ndërhyrjen kundër ngacmimeve dhe dhunës seksuale brenda partisë tuaj politike			
Masa ose programe të adoptuara për sensibilizimin e anëtarëve të partisë për çështjet e barazisë gjinore			
Burime të veçanta të alokuara për gratë Kandidate në zgjedhje			

Tjetër (Ju lutem specifikojeni)

A mendoni se numri i grave në strukturat e ndryshme partisë suaj është i mjaftueshëm? \*

- Po
- Jo
- Nuk e di

Ju lutem shpjegoni përgjigjen tuaj

A mund ta citojmë përgjigjen tuaj në studim?

- Po
- Jo

Sipas informacioneve që ju keni, cilat janë detyrat kryesore të forumit të grave në partinë tuaj?

	Po	Pjesërisht	Jo	Nuk e di
Ofrojnë mbështetje organizative dhe logjistike për partinë politike				
Ofrojnë kontributin e tyre në vendimmarrje në parti				
Ndërmarrin aktivitete për promovimin e pjesëmarrjes së grave në jetën politike				
Mbështesin grate kandidatë gjatë zgjedhjeve				
Ofrojnë mbështetje për grate e zgjedhura në parlament				
Mobilizojnë votën e grave përpara zgjedhjeve				
Mbrojnë çështjet gjinore brenda partisë				

Tjetër (Ju lutem specifikojeni)

Sa efektiv është forumi i grave në mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në partinë tuaj politike?\*

- Shumë
- Mjaftueshëm
- Jo shumë
- Aspak
- Nuk e di

Ju lutem shpjegoni përgjigjen tuaj.

Si mendoni se do të mund të fuqizohet Forumi i Grave brenda partisë?

A mund ta citojmë përgjigjen tuaj në studim?

- Po
- Jo

A keni ndjekur trajnime të specializuara në fushat e mëposhtme? \*

	Po	Jo
Buxheti		
Barazia Gjinore dhe Integrimi gjinor		
Institucionet dhe procedurat legjislative		
Komunikimi dhe e folura ne publik		
Funksionimi i partive politike		
Media		

---

Fushatat Zgjedhore		
Lidershipi		

**Trajnime të specializuara - Tjetër (Ju lutem specifikoni)**

Për trajnimet që keni marrë, sipas informacionit që keni, ju lutemi specifikoni nga kush janë organizuar (për shembull nga partia politike, nga organizata joqeveritare, nga organizata rajonale dhe ndërkombëtare, etj).\*

## REKOMANDIME

Sipas mendimit tuaj, çfarë strukturash, shërbimesh apo nismash të reja, do të sugjeronit për ta bërë partinë tuaj politike më të ndjeshme ndaj nevojave të grave brenda partisë? Ju lutem shpjegoni përgjigjen tuaj.

A mund ta citojmë përgjigjen tuaj në studim?\*

- Po
- Jo

Sipas mendimit tuaj, çfarë mund të bëhet më shumë për të forcuar dhe mbështetur rolin e gruas në partinë politike?\*

A mund ta citojmë përgjigjen tuaj në studim?\*

- Po
- Jo



Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.



[www.wfd.org](http://www.wfd.org)



[@WFD\\_Democracy](https://twitter.com/WFD_Democracy)



[@WestminsterFoundation](https://www.facebook.com/WestminsterFoundation)



**WFD**

Westminster Foundation for Democracy  
is an executive non-departmental  
Public Body sponsored by the Foreign,  
Commonwealth & Development Office.



**UK Government**